



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Financë dhe Tregje Financiare”**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "REALD"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Dritan Fino

2. Dr. Alban Korbi

Shkurt /2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 420, datë 16.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	I dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6/0
18	Numri i studentëve:	24
19	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Kolegji Universitar “REALD” (KUR) është një institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011, si Akademia e Studimeve të Aplikuara “REALD”. Në vitin 2017 është riorganizuar duke marrë emrin Kolegji Universitar “REALD”.

Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr. 93, datë 20.10.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike e vlefshme deri më deri në 19/10/2022.

KUR përbëhet nga 2 njësi kryesore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Secili fakultet përbëhet nga 3 njësi bazë, si vijon:

Fakulteti i Ekonomisë: Departamenti i Financës, Departamenti i Menaxhimit dhe një Qendër Kërkimore;

Fakulteti i Shkencave Mjekësore: Departamenti i Farmacisë, Departamenti i Stomatologjisë dhe Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare” është hapur me UMASH NR. 420 datë 16.07.2018 me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, 120 kredite. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Financës, Fakulteti i Ekonomisë.

Raporti i vlerësimit nga ekspertët e jashtëm, shqyrton ecurinë e programit të studimit Master I Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare”, i cili i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë.

Procesi i vlerësimit të jashtëm është fokusuar në:

- Programin e studimit,
- Misionin e programit,
- Kurrikulën,
- Stafin Akademik: të brëndshëm dhe me kontratë,
- Procesin e formimit profesional të studentëve,
- Kërkimin shkencor,
- Funkcionimin e infrastrukturave,
- Bashkëpunimin me partnerët kombëtare dhe ndërkombëtarë.

Raporti përshkruan analizën e situatës, treguesit e matshëm, si dhe shkallën e përmbushjes së standardeve sipas rubrikave të Kodit të cilësisë. Për secilin standard, ekspertët japin vlerësimet respektive. Gjatë vlerësimit u realizuan edhe vizitat në terren me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së kriterëve përbërës të gjashtë fushave kryesore të cilësisë së programit të studimit.

Raporti i vlerësimit është hartuar nga grupi i ekspertëve të jashtëm të vlerësimit i cili përbëhet nga: Dr. Dritan Fino dhe Dr. Alban Korbi. Gjatë gjithë procedurës së vlerësimit të jashtëm GVJ është asistuar nga Koordinatorët teknik të ASCAL, Msc. Ersi Dako dhe Msc Erjon Xhako.

Paraprakisht, anëtarët e grupit morën pjesë në një seancë trajnimi të zhvilluar nga specialistët e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

 4 

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

GVJ për haritmin e këtij raporti u bazua në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit që institucioni ka vënë në dispozicion përmes sistemit të menaxhimit të ASCAL (AMS), në dokumentacionin shtesë të kërkuar gjatë vizitës në institucion, të administruar zyrtarisht si dhe në opinionet e shprehura nga takimet gjatë vizitës institucion, në datat 15/10/20 dhe 16/10/20.

Gjatë vizitave u kryen takime dhe intervista të shumta me hartuesit e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB), me personelin drejtues, akademik, administrativ dhe me studentët që ndjekin programin Master i Shkencave në Financë dhe Tregje Financiare.

Gjatë vizitave u krye edhe shqyrtimi fizik i të gjitha ambienteve të institucionit dhe atij bazë përgjegjës për programin e studimit.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) përbëhet nga 6 fusha kryesore. Çdo fushë është analizuar dhe vlerësuar, nëpërmjet standardeve përkatëse.

Analiza përmban vlerësimin për çdo kriter të secilit standard, duke vlerësuar të dhënat e deklaruara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të përgatitur nga institucioni. GVJ ka evidentuar ndryshimet dhe ka vlerësuar nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me kriteret specifike. Për secilin standard, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është përgjigjur konkretisht për çdo kriter dhe për çdo standard, për shkallën e përmbushjes. Raporti përmbyllet me një analizë përmbledhëse të anëve të forta dhe të dobëta lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare”. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u prit mjaft mirë nga personeli i institucionit dhe i falenderon për zemërsisht të gjithë për bashkëpunimin e plotë dhe transparent gjatë gjithë këtij procesi.

Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u dërgua në institucion me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare nr. 20/02 Prot. datë 18.01.2021. Institucioni ka kthyer përgjigje mbi Draft Raportin, më datë 19.01.2021, me anë të sistemit AMS, duke u shprehur se nuk ka komente mbi Draft Raportin, si rrjedhojë Draft Raporti merr formën e tij finale në, Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE “FINANCË DHE TREGJE FINANCIARE”

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Referuar Strategjisë së Zhvillimit të Kolegjit, nenit 4 të Statutit të Kolegjit Universitar “REALD” (KUR) dhe nenit 32 të Rregullores të KUR, u konstatua se programet e studimit nuk bien ndesh me interesat kombëtare, kjo për shkak të natyrës specifike shkencore të degëve të ndryshme të ofruara. Kjo vlen gjithashtu për programin Master i Shkencave në ‘Financë dhe Tregje Financiare’, i cili synon të pajisë të diplomuarit me njohuri të thella teorike, si edhe me aftësim për kërkimin shkencor në sferën ekonomike, në fushën e financës dhe tregjeve financiare. Gjithashtu, ky program synon të ndihmojë individët dhe të orientojë organizatat në punësimin e tyre, me qëllim rritjen e efektivitetit të tyre manaxherial përmes fushës së financës, duke u siguruar studentëve një bazë të fortë me parimet dhe praktikat e financës duke u siguruar atyre mjetet e nevojshme analitike dhe aftësi të reja për formimin e një baze të fortë në vendimarrjen financiare. Programet e studimit të KUR mbështeten në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. KUR ka për mision dhe qëllim, midis të tjerash, të zhvillojë programe mësimore dhe kërkimore në përputhje me prioritetet dhe interesat e zhvillimit të vendit.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit, nenin 4 të Statutit të Kolegjit Universitar “REALD” (KUR), dhe nenit 32 të Rregullores të KUR, u konstatua se programet hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës, me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Sipas rregullores së programit, ky program u krijon studentëve mundësi punësimin si punonjës të: institucioneve financiare (publike e private), të departamenteve financiare e ekonomike të bashkive, drejtues korporatash apo menaxher kryesor; gjithashtu ky program është i dobishëm për individë që përballen me financën në rolet e tyre aktuale, dhe që duan të

	<p>avancojnë në karrierën e tyre apo të ndërrojnë fushën e tyre me financën duke u bazuar te njohuritë e tyre financiare si :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studentë që kanë një diplomë të nivelit të parë në Financë, Marketing, Kontabilitet, Biznes, Turizëm, etj. 2. Investues, tregtarë dhe bankierë. 3. Punonjës të analizave të tregjeve kapitale dhe manaxhimit të riskut. 4. Punonjës të korporatave financiare, bashkimeve të kapitalit. 5. Punonjës të organizatave të shërbimeve, si ato të konsulencave financiare dhe korporatave financiare të përbashkëta. <p>Ky program është formuluar për studentë me kombësi të ndryshme, background-e të ndryshme kulturore që mund të sjellin në këtë program eksperiencë të ndryshme, motivim dhe sfida të reja. Është program i përshtatshëm për të gjithë ata që kanë një interes të madh në karrierën e përgjithshme financiare, ose për ata që planifikojnë të ndryshojnë karrierën e tyre në financë.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Në mbështetje të nenit 4 të Statutit të Kolegjit Universitar “REALD” (KUR), dhe nenit 32 të Rregullores të KUR, u evidentuan se misioni dhe qëllimet e KUR lidhen, midis të tjerash, me kontribuimin në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare; me zhvillimin e programeve mësimore dhe kërkimore në përputhje me prioritetet dhe interesat e zhvillimit të vendit; me kontribuimin në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushat e miratuara të arsimit të lartë, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit; kryerjen e studimeve kërkimore shkencore përputhje me prioritetet dhe interesat e zhvillimit të vendit; ofrimin e mundësive më të mira për të përfituar nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; në kontribuimin në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit; si dhe në kontribuimin në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushat e miratuara të arsimit të lartë. Misioni i programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në ‘Financë dhe Tregje Financiare’ është përgatitja e specialistëve të financës dhe tregjeve financiare’, me qëllim kryesor punësimin si punonjës të: institucioneve financiare (publike e private), të departamenteve financiare e ekonomike të Bashkive, drejtues korporatash apo menaxher kryesor; gjithashtu ky program është i dobishëm për individë që përballen me financën në rolet e tyre aktuale dhe që duan të avancojnë në karrierën e tyre apo të ndërrojnë fushën e tyre me financën duke u bazuar te njohuritë e tyre financiare. Programi është hartuar në përputhje me Strategjinë për zhvillim (2016-2021) të KUR, miratuar me Vendim të Bordit Drejtues nr. 42, datë 11.01.2016.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i</p>	<p>Në mbështetje të nenit 4 të Statutit të Kolegjit Universitar “REALD” (KUR), dhe nenit 32 të Rregullores të KUR, theksohet, midis të tjerash,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

 7 

<p>arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>se: ‘KUR ka për mision dhe qëllim, midis të tjerash, të zhvillojë programe mësimore dhe kërkimore në përputhje me prioritetet dhe interesat e zhvillimit të vendit’.</p> <p>Një prej objektivave të studimeve në Fakultetin e Ekonomisë të KUR lidhet me zhvillimin e programeve të reja të studimit në përshtatje me nevojat e shoqërisë, kushtet ekzistuese dhe perspektivat e zhvillimit të vendit tonë. Megjithatë këto objektiva nuk janë reflektuar me tej në hartimin e një studimi tregu. GVJ është e mendimit se institucioni duhet të hartojë një studim tregu për të patur një pasqyrë më të qartë të kërkesës së tregut sidomos në rajonin ku bën pjesë IAL. Studimi i tregut i cili gjendet në dosjen e vetëvlerësimit që IAL ka dorëzuar është një studim i përgjithshëm dhe me fokus në turizëm, rrjedhimisht nuk jep një pasqyrë të qartë të situatës për këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Bazuar në programin e studimit të ciklit të dytë Msc në “Financë dhe Tregje Financiare”, ky program fokusohet në çështjet e financave të korporatave/institucioneve publike dhe private me theks në zhvillimin dhe aplikimin e aftësive të modelimit financiar. Ai fokusohet në drejtimin financiar të bizneseve dhe administrimin e financave publike, planifikimit dhe menaxhimit në sektorin e tatimeve dhe doganave, drejtimit të teknikave bankare dhe sigurimeve, analizës së riskut dhe investimeve, tregjeve financiare dhe ndërmjetësimit financiar në tërësi si dhe përdorimit dhe interpretimit të pasqyrave financiare, etj. Përfundimi me sukses i këtij programi u mundëson studentëve edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike, nëpërmjet vazhdimin të studimeve të doktoraturës, duke rritur mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Referuar Planit Strategjik të KUR, rregullores së KUR, si dhe dosjes së programit të studimit Msc “Financë dhe Tregje Financiare”, programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në ‘Financë dhe Tregje Financiare’ është hartuar në përshtatje me planin strategjik të zhvillimit të institucionit 2016- 2021, i cili ka si objektiva kryesorë, midis të tjerash, sigurimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, një detyrë kryesore e personelit akademik dhe strukturave të KUR.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Duke u bazuar në statutin e KUR, në rregulloren e KUR, në rregulloren e programit të studimit Msc “Financë dhe Tregje Financiare”, vihet re se ky program është hartuar në përshtatje me statutin dhe rregulloren e KUR.</p> <p>Lëndët dhe modulet e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare” i japin mundësi studentëve për një karrierë profesionale, por që kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm për një pozicionim më të qartë në karrierën e ardhshme profesionale të studentëve.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar ‘REALD’, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij në Ekonomi.</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Në mbështetje të statutit të KUR, të rregullores së KUR, të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë si dhe të rregullores së programit të studimit, theksojmë se KUR zhvillon mësimdhënie cilësore në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në dy Fakultete: Fakulteti i Ekonomisë si dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore si dhe Programe dy-vjeçare. Institucioni ofron programe studimi Bachelor: Menaxhim dhe Financë; Master i Shkencave në Financë dhe Tregje Financiare.</p> <p>Studimet në Fakultetin e Ekonomisë të KUR synojnë arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e ekonomisë: më konkretisht në fushën e menaxhimit të ndërmarrjeve, financës dhe kontabilitetit.</p> <p>Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare” ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Bazuar në statutin e KUR, të dosjes së programit dhe të rregullores së programit të studimit, theksojmë se KUR ka për mision dhe qëllim, midis të tjerash, të zhvillojë programe mësimore dhe kërkimore në përputhje me prioritetet dhe interesat e zhvillimit të vendit.</p> <p>Një prej objektivave të studimeve në fakultetin e Ekonomisë të KUR lidhet me zhvillimin e programeve të reja të studimit në përshtatje me nevojat e shoqërisë, kushtet ekzistuese dhe perspektivat e zhvillimit të vendit tonë, si dhe me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare. Programi MSc mbështet edhe në strategjinë kombëtare të zhvillimit për integrim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Referuar dosjes së programit të studimit Msc në “Financë dhe Tregje Financiare”, rregullores së programit të studimit, si dhe syllabuseve të lëndëve të programit, vihet re se objektivat, misioni, struktura, mënyra e funksionimit të studimeve, si dhe të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik, studentëve, mësimdhënies, praktikave, diplomimit dhe sanksionet në rast të shkeljes së rregullores për programin e studimit të ciklit të dytë Msc në “Financë dhe Tregje Financiare” janë të përcaktuara në rregulloren përkatëse. Në çdo program lënde përfshihet përshkrimi përkatës, objektivat, temat, konceptet themelore, përmbajtja, literatura, detyrimet e studentit dhe sistemi i vlerësimit të tij, ajo që vihet re në syllabuset e çdo lënde është mungesa e reflektimit të praktikës të studentit, duke patur vetem leksione dhe seminare.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Sipas takimit të zhvilluar me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, përpara hapjes së programit të studimit, KUR ka kryer një analizë të tregut të punës. Studimi synon të kryejë një analizë të përditësuar të kërkesës/ofertës, duke krahasuar ndryshimet e tregut të punës për profesione të ndryshme me ofertën prezente në këtë treg për personel të specializuar në fushën e financës dhe tregjeve financiare. Nga studimi i tregut u evidentua që tregu ka nevoja për specialistë në fushën e financës dhe tregjeve financiare si dhe janë evidentuar shumë probleme ekonomike, sidomos në financat në vendin tonë. Vlerësimi i tregut u realizua nëpërmjet kontakteve direkte që ka patur institucioni me institucione të tjera në të cilat janë punësuar apo kanë zhvilluar praktikën profesionale studentët e këtij programi. Në këtë kuadër, u evidentua se ekziston mundësia që nga ana e universitetit të merret në vazhdim një vlerësim nga tregu direkt i punësimit të studentëve, i cili do të shërbejë dhe si një feedback për përmirësimin e programit të ndjekur nga specialistët e kësaj fushe.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Pavarësisht konkluzioneve të rëndësishme të këtij studimi, autorët nuk japin sqarime të detajuara mbi metodologjinë statistikore të përdorur, si dhe mbi statistikatat përshkruese të lidhura me kampionët e përdorur. Në bazë të opinionit tonë si ekspertë të ekonomisë dhe financës, gjykojmë se tregut shqiptar të punës i nevojiten të diplomuar nga programe me fokus më të ngushtë ose më specifik. Pavarësisht se ky program studimi ka si qëllim pajisjen me njohuri të thella teorike, si edhe me aftësim për kërkimin shkencor në sferën ekonomike, në fushën e financës dhe tregjeve financiare si dhe të ndihmojë individët dhe të orientojë organizatat në punësimin e tyre, mbështetur në rregulloren e programit të studimit Msc “Financë dhe Tregje Financiare” si dhe në syllabusin e lëndëve të programit, emërtimi dhe objektivat e programit të studimit të</p>

	ciklit të dytë Msc në “Financë dhe Tregje Financiare” përfshijnë, në gjykimin tonë, një fushë ‘të gjerë’.			
Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Sipas Statutit të KUR neni 63, 66, 71 dhe 75, rregullores së KUR, neni 36, evidentohet se KUR ofron mundësi për njohjen e krediteve sipas kërkesave për vazhdimin ose transferimin e studimeve, midis të njëjtit cikël, brenda të njëjtit institucion ose në institucione të tjera brenda vendit. Gjithashtu, theksojmë se programi Master i Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare” është ndërtuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Ligji për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, Standardet Shtetërore të Cilësisë, Karta e Bolonjës, ZEAL (Zona Europiane e Arsmi të Lartë). Ky program është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë. Ky program është vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe Kartës së Bolonjës.			
Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	Referuar rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, neni 29, 30 dhe programit të studimit Msc “Financë dhe Tregje Financiare”, u konstatua se ky program përmban si modul të veçantë praktikën, me 12 kredite, ku praktika realizohet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Zakonisht, studentët grupohen dhe ndiqen nga një pedagog.			
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Referuar rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, neni 29, 30 dhe programit të studimit Msc “Financë dhe Tregje Financiare”, u konstatua se ky program përmban si modul të veçantë praktikën, me 12 kredite, ku praktika realizohet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Zakonisht, studentët grupohen dhe ndiqen nga një pedagog.			
Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	Sipas listës së bashkëpunimeve ndër-institucionale, si dhe bazuar në intervistat e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, u konstatua se në KUR nuk ka mësimdhënie, as lëndë në gjuhë të huaj në asnjë program studimi. Gjithashtu nuk ruan dhe arkivon dokumentacion në gjuhën angleze. Në rastet kur ka studentë të huaj, lënda bëhet në shqip dhe shoqërohet me përkthyes nëse ka nevojë.			
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit të KUR, organigramës së Fakultetit të Ekonomisë, numrit të stafit akademik për këtë program studimi si dhe vizitës në institucion nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm, sipas datave të programuara, në zyrën e burimeve njerëzore, u evidentua se deri në vitin 2019-2020 kanë qenë 6 pedagogë të brendshëm të angazhuar në këtë program studimi, me titull Dr. dhe Prof. As. Ndërsa për vitin akademik 2020-2021, janë 7 pedagogë, 4 të brendshëm dhe 3 të jashtëm.</p> <p>Gjithashtu, u evidentua se kishte disa parregullsi midis tabelave të mbledhura me të dhënat e pedagogëve dhe emrave të paraqitur në syllabuset dhe dosjen e programit të studimit.</p> <p>Pjesë e KUR është edhe Qendra Kërkimore Shkencore, e cila është organizuar në bazë të neneve 83-86 të statutit të KUR. Kjo Qendër duhet të fokusojë më shumë burime në realizimin e aktiviteteve shkencore të lidhura me këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Sipas dosjes së programit Msc “Financë dhe Tregje Financiare”, ky program është në sinkron me nevojat e shoqërisë dhe kushtet ekzistuese të vendit, duke synuar të sigurojë njohuri të krahasueshme me institucionet analoge universitare brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Duke u bazuar në CV-të e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të programit të studimit përgjithësisht mund të konfirmohet përputhja e karrierës akademike me mësimdhënien në lëndën përkatëse, pjesë e programit të studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, si dhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në vijim të planit strategjik të zhvillimit të KUR si dhe listës së bashkëpunimit ndërinstitucional të tij, u konstatua se institucioni ka krijuar lidhje me universitete të tjera kërkimore shkencore, si Universiteti “Luarasi”, Universiteti Mesines dhe Salerno, Itali si dhe Kolegji “Pjetër Budi”, Kosovë. Bazuar në rregulloren e KUR, strategjinë e zhvillimit si dhe rregulloren e programit të studimit Msc “Financë dhe Tregje Financiare”, theksojmë se njësia përgjegjëse, synon të angazhojë stafin akademik dhe studentët në projekte dhe kërkim shkencor, mbledhje të përbashkëta, diskutimet për planet e programet mësimore, në plotësimin e nevojave për pasurimin e bazës materiale mësimore dhe didaktike. Megjithatë ky angazhim ka nevojë të rritet më shumë. Njësia përgjegjëse, duhet të organizojë aktivitete të mirfillta, konferenca për fushën e programit të studimit të cilat do të ndihmojnë arritjen e objektivave nga personeli dhe studentët. KUR ka dhe revistën shkencore me botimet përkatëse.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Mbështetur në listën e bashkëpunimit ndërinstitucional të institucionit, u konstatua se, KUR ka bashkëpunime ndërinstitucionale me institucione publike e private, me një sërë institucionesh shtetërore dhe IAL brenda e jashtë vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës në përgjithësi. Studentët mund të lëvizin në kuadër të projekteve të ndryshme, ku KUR është palë. Atyre u njihen kreditet e mundshme të fituara nëse programet përkatëse janë të barasvlershme.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Kryesisht, objektivat e këtyre bashkëpunimeve janë realizimi i praktikave profesionale me studentët sipas profilit, shkëmbimi i përvojave reciproke, krijimi i mundësive të punësimit me kohë të pjesshme të studentëve dhe në profil pas përfundimit të studimevetë cilat e ndihmojnë për të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe riorganizuar programin në përputhje me vizionin strategjik të zhvillimit të ekonomisë shqiptare. Gjithashtu, këto marrëveshje bashkëpunimi vlejné dhe për praktikat profesionale të kryera nga studentët, të cilat mnikëqyren nga një pedagog për një grup të caktuar studentësh. KUR harton dhe përgatit një raport analitik mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, të përqëndruar kryesisht në praktikën profesionale.
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e	

bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.6				
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Në mbështetje të konkluzioneve të nxjerra nga vizita në terren, u konstatua se veprimtaria dhe kërkimi shkencor realizohet në përputhje me statutin e KUR, rregulloren e programit të studimit si dhe Strategjinë e Zhvillimit 2016-2021. Siç është përmendur edhe mësipër, KUR ka të ngritur edhe Qendrën Kërkimore Shkencore, e cila është organizuar në bazë të neneve 83-86 të statutit të KUR. Kjo qëndër duhet të rrisë fokusin në zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushën e këtij programi studimi.			
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni ka një politikë mbështetëse për pjesëmarrjen e stafit në kërkimin shkencor, nëpërmjet bashkëpunimeve dhe me institucione të tjera. Institucioni nxit stafin akademik edhe studentët për pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme shkencore si dhe ka një revistë shkencore me punimet përkatëse të stafit dhe studentëve.			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Megjithatë vihet re një pjesëmarrje e ulët e stafit akademik në aktivitete kërkimore shkencore, nga dokomencioni i venë në dispozicion (Aneksi 53), nuk vihet re asnjë botim i stafit akademik në revista shkencore.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.				
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Standardi II.1

Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Mbështetur në rregulloren e programit të studimit Msc “Financë dhe Tregje Financiare”, në dosjen e plotë të programit, në planin mësimor, syllabuset e lëndëve si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, u konstatua se ky program studimi, është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Sipas planit mësimor, ky program studimi u krijon mundësi, në mënyrë të veçantë ekonomisteve të cilët do të përfitonin studime të thelluara në fushën e gjerë të financës dhe të tregjeve financiare me qëllim kryesor punësimin si punonjës të: institucioneve financiare (publike e private), të departamenteve financiare e ekonomike të Bashkive, drejtues korporatash apo menaxher kryesor; gjithashtu ky program studimi është i dobishëm për individë që përballen me financën në rolet e tyre aktuale, dhe që duan të avancojnë në karrierën e tyre apo të ndërrojnë fushën e tyre me financën duke u bazuar te njohuritë e tyre financiare si :
Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	1. Studentë që kanë një diplomë të nivelit të parë në Financë, Marketing, Kontabilitet, Biznes, Turizëm, etj. 2. Investues, tregtarë dhe bankierë. 3. Punonjës të analizave të tregjeve kapitale dhe manaxhimit të riskut. 4. Punonjës të korporatave financiare, bashkimeve të kapitalit. 5. Punonjës të organizatave të shërbimeve, si ato të konsulencave financiare dhe korporatave financiare të përbashkëta. 6. Ky program studimi është formuluar për studentë me kombësi të ndryshme, background-e të ndryshme kulturore që mund të sjellin në këtë program eksperiencë të ndryshme, motivim dhe sfida të reja. 7. Është program i përshtatshëm për të gjithë ata që kanë një interes të madh në karrierën e përgjithshme financiare, ose për ata që planifikojnë të ndryshojnë karrierën e tyre në financë.
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Planet dhe programet e disiplinave respektive të detajuara, të shoqëruara me kreditet përkatëse, hartohen dhe miratohen në departament. Për çdo lëndë ose modul, pedagogu përkatës paraqet një program, i cili hartohet sipas formatit të miratuar. Kreditet për çdo lëndë mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore dhe punën individuale që duhet kryer nga student, GVJ rekomandon që kreditet për çdo lëndë të jenë të ndara sipas rëndësisë specifike të lëndëve, nderkohë që në planin mësimor aktual çdo lëndë, pavarësisht kategorisë, ka 6 kredite .
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulët sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e	



<p>diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit miratohet gjithashtu në Senatin Akademik të KUR dhe më tej hapja e çdo programi të ri miratohet nga Ministria Përgjegjëse. Kohëzgjatja normale e programit të studimit të Msc në “Financë dhe Tregje financiare” është 2 vite akademike me 4 semestra gjithsej (120 kredite).</p> <p>Viti akademik ndahet në dy semestra, ku në semestrin e parë të vitit të dytë është parashikuar praktika profesionale dhe në semestrin e dytë të vitit të dytë diploma, të cilat kanë nga 12 kredite. Programi i studimit Msc në “Financë dhe Tregje Financiare” përmban lëndë secila me provimin përkatës.</p> <p>Në këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm ky program ka vënd për përmirësim duke përfshirë lëndë më specifike të fushës së tregjeve financiare.</p> <p>Në programin e studimit Msc në “Financë dhe Tregje Financiare” janë përfshirë elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit si kreditet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivat formues dhe kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit, kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi, rezultatet e pritshme, mënyra e vlerësimit, literature e detyruar dhe ajo e rekomanduar, plani mësimor; kuotat e pranimit dhe grupet mësimore, programi lëndor (Syllabus-et), profilin i programit, diploma dhe suplementin.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” është akredituar institucionalisht me vendimin e Bordit të Akreditimit Nr 650, datë 14.09.2011. KUR funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në kuadrin rregullues të nxjerrë nga MASR.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Te dhena per personelin akademik - per vitin akademik 2019 – 2020</i>”, organigramës së Fakultetit të Ekonomisë, dhe vizitës në institucion nga ekspertët e vlerësimit, sipas datave të programuara, në zyrën e burimeve njerëzore, rezulton se njësia kryesore në vitin akademik 2019-2020 përbëhet nga 22 personel akademik (21</p>

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>PAE dhe 1 PAK), i ndarë në, Departamenti i Menaxhimit, Departamenti i Financës dhe Qendra e Kërkimeve Shkencore. Secila nga njësitë bazë të përmendura mësipër përbehet nga të paktën 7 staf akademik PAE nga të cilët të paktën tre me tituj e grada, më konkretisht Departamenti i Menaxhimit përbehet nga 8 staf akademik (7 PAE dhe 1 PAK) nga të cilët 1 Prof; 1 Prof As; 1 Dr dhe 5 Msc. Departamenti i Financës përbehet nga 7 staf akademik PAE nga të cilët 2 Prof As; 2 Dr dhe 3 Msc. Po ashtu edhe Qendra e Kërkimeve Shkencore përbehet nga 7 staf akademik PAE. Gjatë vizitës në vend, u bë e mundur analiza e dosjeve të stafit PAE. Nga sa mësipër, u evidentua se kishte disa pasaktësi midis tabelave të mbledhura me të dhënat e pedagogëve dhe emrave të paraqitur në syllabuset dhe dosjen e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Studentët e KUR kanë në dispozicion sallën e informatikës, sallën multifunkionale, e cila nuk ka punonjës, por asistohet nga drejtori i qendrës së kërkimit dhe sallën e konferencave. KUR angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e projekteve studimore, kërkimore etj, pjesë e programit të studimit të Msc në ‘Financë dhe Tregje Financiare’.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Sipas rregullores së KUR, Statutit të KUR, vendimi nr. 27, datë 10.12.2018 “Për emërimin e koordinatorit të programit të studimit” si dhe bazuar në dokumentin që përcakton detyrat e koordinatorit, koordinatori i programit të studimit të Msc në ‘Financë dhe Tregje Financiare’ emërohet nga Rektori i Kolegjit. Koordinatori është në mbështetje të punës të përgjegjës të departamentit dhe përgjigjet për përmbushjen e misionit të programit të studimit dhe ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për veprimtarinë e gjithanshme të saj.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>a) Drejton punën për hartimin, ndryshimin e rregullores së programit të studimit për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit; për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik të programit: planin mësimor, programet mësimore, paketën e praktikës dhe të udhëzimeve për tezën; për hartimin e planit të kërkimit.</p>
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>b) Administron dokumentacionin e programi mësimor.</p> <p>c) Ndjek zbatimin e orarit të mësimoreve, të provimeve dhe praktiken mesimore.</p> <p>d) Propozon ngritjen e komisionit të provimeve.</p> <p>e) Ndjek ecurinë e procesit mësimor.</p> <p>f) Ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe të procesit të tezës.</p> <p>g) Propozon kriteret e pranimit të studentëve, komisionet e pranimit të studentëve, komisionin e tezës, komisionet e diplomimit.</p> <p>h) Në bashkëpunim me përgjegjës të njësive, organizon konkursin e pranimit të studentëve të rinj dhe shpall fituesit.</p> <p>i) Propozon kriteret e pranimit dhe kandidaturat e personelit akademik dhe të personelit ndihmës të programit.</p>

	j) Ndjek bashkëpunimin me partnerët. k) Propozon masa ndëshkimore për pedagogët dhe studentët që shkelin rregulloren.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në Rregulloren e Fakultetit Ekonomik, si dhe dosjen e plotë të programit të studimit, vihet re se, Fakulteti Ekonomik i KUR, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë të Msc në “Financë dhe Tregje Financiare”, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Nga ana e këtij kolegji është realizuar dhe studimi i tregut, përpara hapjes së këtij programi studimi, megjithatë ky studim tregu është i limituar dhe nuk tregon një pasqyrë të qartë të nevojave të tregut për specialist në fushën e finances dhe tregjeve financiare.
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Referuar rregullores së programit të studimit Msc në “Financë dhe Tregje Financiare”, dosjes së plotë të programit si dhe konkluzioneve të nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, u evidentua se modulet e këtij programi janë në funksion të objektivave formuese dhe kompetencat profesionale përcaktuese në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Pas përfundimit të studimit 2-vjeçar të integruara me 120 ECTS, studenti pëfiton një diplomë universitare të ciklit të dytë të Nivelit 7. Programi i studimit të Msc në “Financë dhe Tregje Financiare” organizohet në lëndë, module, e aktivitete formuese. Rregullorja e këtij programi përcakton objektivat, misionin, strukturën dhe mënyrën e funksionimit të studimeve, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, stafit akademik, studentëve, mësimdhënien, vlerësimin, diplomën, etj.
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Në programin e studimit Msc në “Financë dhe Tregje Financiare” janë përfshirë elementet që përbëjnë strukturën e tij të studimit si kreditet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivat formues dhe kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit, kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi, rezultatet e pritshme, mënyra e vlerësimit, literature e detyruar dhe ajo e rekomanduar, plani mësimor;
Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit,	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	kuotat e pranimit dhe grupet mësimore, programi lëndor (Syllabus-et), profilin i programit, diploma dhe suplementin. Sipas syllabuseve, mënyra e vlerësimit ndahet në vlerësim të vazhduar 30%, nga të cilat 5% është frekuentimi, 5% aktivizimi, 5% detyrat e kursit dhe 15 % provimi i ndërmjetëm dhe 70% është provimi përfundimtar. Vihet re se literature e detyruar dhe ajo e rekomanduar në pothuajse të gjitha syllabuset e lëndëve është e vjetër dhe nuk i përket 5 viteve të fundit, Rekomandohet që kjo literature të përditësohet me botime të viteve të fundit.			
Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Kriteret për pranimin e studentëve në këtë program janë përcaktuar në rregulloren e KUR si dhe në rregulloren e programit (shqyrtimi në bazë të mesatares së ciklit të parë të studimeve), mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës.			
Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Referuar planit mësimor, syllabuseve, dosjes së plotë të programit dhe RVB, programi i studimit të Msc në ‘Financë dhe Tregje Financiare’ është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Secila nga lëndët e programit është e ndarë në 30 orë seminare dhe 30 orë leksione. GVJ rekomandon që kjo ndarje të rishikohet në bazë të kategorisë dhe rëndësisë specifike të çdo lënde. Në gjykimin e GVJ lëndët karakterizuese të programit duhen të kenë një peshë me të madhe në program dhe rrjedhimisht kjo reflektuar dhe në orë apo kredite.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	Bazuar në rregulloren e fakultetit ekonomik, rregulloren e programit të studimit finance dhe tregje financiare si dhe në rregulloren e sekretarisë mësimore, u konstatua se të dhënat e grumbulluara për programin e studimit ruhen në një dosje të veçantë në arkivën e fakultetit vetëm në gjuhën shqipe. KUR nuk ruan dhe arkivon dokumentacion në gjuhën angleze. Këto të dhëna konsultohen për përmirësime eventuale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me	Mbështetur në ngarkesën e orëve totale të stafit si dhe në dosjen e plotë të programit, vihet re se ngarkesa e programit të studimit Msc në “Financë dhe Tregje Financiare” është strukturuar në përmbushje Ligjit të Arsimit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	të Lartë Nr.80/2015 si dhe të Udhëzimit Nr 31 të MASR në total janë 1500 ku një kredit i korensponon 25 orëve mesimore. Ngarkesa mësimore në auditor, për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm të zhvilluara në auditor për programin e studimit është 960 orë dhe kjo ngarkesë mbulohet e gjitha nga stafi i brendshëm. Megjithatë referuar planit mësimor vihet re se mungon ndarja në orë e praktikës mesomore dhe temës së diplomës. Gjithashtu nga institucioni deklarohet se në këtë program studimi për vitin akademik 2019-2020, janë të përfshirë 6 staf akademik, ndërsa në dokumentin “Ngarkesa mesimore e stafit akademik ne Msc. Finance dhe Tregje Financiare 2018-2019 dhe 2019-2020”, rezultojnë vetëm 5 staf akademik për këtë program studimi.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Referuar planit mësimor dhe syllabuseve të programit të studimit Msc “Financë dhe Tregje Financiare”, konstatohet se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve të programit të studimit, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe punësimin e studentëve.
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Mbështetur në dosjen e plotë të programit të studimit Msc në “Financë dhe Tregje Financiare”, u konstatua se, për ngritjen e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës kurrikulare janë shfrytëzuar marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar (me Universitetin Luarasi dhe Universiteti i Salernos, Mesines Itali) . KUR ofron mundësi për njohjen e krediteve sipas kërkesave për vazhdimin ose transferimin e studimeve, midis të njëjtit cikël, brenda të njëjtit institucion ose në institucione të tjerë brenda dhe jashtë vendit.
Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi Msc në ‘Financë dhe tregje financiare’ është ndërtuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, Standardet Shtetërore të Cilësisë, Karta e Bolonjës, ZEAL (Zona Europiane e Arsimit të Lartë). Megjithatë sa i përket raportit teori-praktikë, në planin mësimor nuk vihen re orë praktike, përveç praktikës profesionale, duke bërë që programi i studimit të ketë ngarkesë të theksuar teorike. GVJ është e mendimit se në planin mësimor duhet të përfshihen dhe praktikat lëndore reflektuar kjo në kreditet përkatëse.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Referuar syllabuseve të programit të studimit, siç u përmend dhe më sipër në këtë raport, literatura e detyruar dhe e rekomanduar nuk është e përditësuar dhe nuk i takon botimeve të 5 viteve të fundit.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	Referuar planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, rezultojnë se studentët pajisen me njohuri dhe kompetenca të duhura të cilat përmbushin kërkesat e ciklit të dytë të pogramave të studimit dhe hedhin bazat për thellimin e njohurive në ciklin e tretë.

Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Megjithatë GVJ është e mendimit se ky program studimi duhet të përfshijë më shumë lëndë specifike të tregjeve financiare, duke qenë se fusha e tij është shumë e gjerë dhe e përgjithshme.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Bazuar në DVV dhe studimit e tregut që institucioni ka realizuar, rezulton se KUR nuk ka kryer një studim të mirëfilltë tregu në fushën e financës por ai ka një qasje më tepër drejt turizmit. Gjithashtu nuk rezulton që institucioni të ketë hartuar ndonjë raport në lidhje me propozimet e bashkëpunëtorëve apo partnerëve. GVJ rekomandon që KUR të realizojë konsultime të dokumentuara me bashkëpunëtorët e tregut të punës si dhe analiza të hartuara nga ekspertë jashtë institucionit.			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Mbështetur në syllabuset për secilën lëndë si dhe në dosjen e plotë të programit të studimit, vihet re se programi Msc në “Financë dhe Tregje Financiare”, u krijon mundësi studentëve të marrin njohuri të avancuara për studimet në ciklin e tretë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Referuar dokumentit “Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit”, rezulton se në vitin akademik 2019- 2020 në këtë program studimi janë angazhuar 6 pedagogë të brendshëm me tituj dhe grada shkencore, 3 me gradën Dr dhe 3 me titull Prof. As.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Gjatë vizitës në vend, u bë e mundur analiza e dosjeve të stafit PAE. Nga analiza e CV-ve të stafit, u evidentua se ky program ka nevojë për pedagogë që kanë njohuri më të thelluara në fushën e tregjeve financiare dhe financës, pasi jo të gjithë pedagogët kanë eksperiencën e duhur. Duke u bazuar në CV-të e personelit akademik efektiv të Msc në ‘Financë dhe Tregje Financiare’, përgjithësisht mund të konfirmohet përputhja e karrierës akademike me mësimdhënien në lëndën përkatëse, pjesë e programit të studimit, por theksojmë se ka nevojë për staf me më shumë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>eksperiencë në fushën e tregjeve financiare. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit të Msc në “Financë dhe Tregje Financiare” është përgjithësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, si dhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit në kuadër të praktikës profesionale të studentëve si dhe duke siguruar shkëmbimin e eksperiencës për pedagogët.</p> <p>Sipas listës së bashkëpunimit ndërinstitucional të kolegjit si dhe bazuar në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, KUR ka bashkëpunime ndërinstitucionale me një sërë institucionesh shtetërore dhe IAL brenda e jashtë vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës në përgjithësi, duke angazhuar edhe stafin e nevojshëm.</p> <p>Kryesisht, objektivat e këtyre bashkëpunimeve janë realizimi i praktikave profesionale me studentët sipas profilit, shkëmbimi i përvojave reciproke, krijimi i mundësive të punësimit me kohë të pjesshme të studentëve dhe në profil pas përfundimit të studimeve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Referuar dokumentave “<i>Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Fakultetit Ekonomik 2019-2020)</i>” dhe “<i>Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit)</i>”, nuk rezulton asnjë personel ndihmës mësimor për mirëmbajtjen apo realizimin e orëve laboratorike.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e</p>	<p>Mbështetur dhe në listën e bashkëpunimit ndërinstitucional të KUR si dhe studimin e tregut të punës, vihet re se KUR nuk kryen në mënyrë periodike konsultime të dokumentuara mbi marrjen parasysh të propozimet nga biznesi privat mbi ndryshimet e tregut të punës apo analiza të jashtme, kjo edhe për shkak se ky program akoma nuk ka nxjerë brezin e pare të studentëve.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.									
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Referuar vizitës në vend, theksojmë se ky KUR inkurajon dhe përfshin në diskutime edhe studentët dhe strukturat e tij. Në institucion funksionon Këshilli Studentor, i cili realizon herë pas here diskutime dhe mbledhje.								
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	KUR ka ngritur zyrën e këshillimit të karrierës me qëllim të orientojë dhe ndihmojë studentët për të bërë zgjedhje të përgjegjshme dhe të qëndrueshme, theksojmë se ky program studimi akoma nuk ka diplomuar studentë duke qënë një program i ri, si rrjedhojë puna e zyrës së këshillimit të karrierës mbetet për tu vlerësuar në akreditimet e ardhshme.								
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Mbështetur në listën e bashkëpunimit ndër-institucional të kolegjit, u konstatua se, KUR ka bashkëpunime ndër-institucionale me institucione publike e private, të cilat e ndihmojnë për të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe riorganizuar programin në përputhje me vizionin strategjik të zhvillimit të ekonomisë shqiptare.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.7

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në mbështetje të nenit 4 të Statutit të Kolegjit Universitar “REALD” (KUR), dhe nenit 32 të Rregullores të KUR, u evidentuan se misioni dhe qëllimet e KUR lidhen, midis të tjerash, me kontribuimin në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare; me zhvillimin e programeve mësimore dhe kërkimore në përputhje me prioritetet dhe interesat e zhvillimit të vendit; me kontribuimin në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushat e miratuara të arsimit të lartë, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit; kryerjen e studimeve kërkimore shkencore përputhje me prioritetet dhe interesat e zhvillimit të vendit; ofrimin e mundësive më të mira për të përfutuar nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; në kontribuimin në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të

	<p>zhvillimit të vendit; si dhe në kontribuimin në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushat e miratuara të arsimit të lartë.</p> <p>Misioni i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencor në ‘Financë’ është përgatitja e specialistëve të ‘Financës dhe tregjeve financiare’, me qëllim kryesor punësimin si punonjës të: institucioneve financiare (publike e private), të departamenteve financiare e ekonomike të Bashkive, drejtues korporatash apo menaxher kryesor; gjithashtu ky master është i dobishëm për individë që përballen me financën në rolet e tyre aktuale, dhe që duan të avancojnë në karrierën e tyre apo të ndërrojnë fushën e tyre me financën duke u bazuar te njohuritë e tyre financiare. Programi është hartuar në përputhje me Strategjinë për zhvillim (2016-2021) të KUR, miratuar me Vendim të Bordit Drejtues nr. 42, datë 11.01.2016.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Bazuar në listën e bashkëpunimit ndërishtitucional të kolegjit, vihet re se KUR synon zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e edukimit, formimit teoriko-profesional, të kërkimit shkencor si edhe në fusha të tjera.</p> <p>Me fokus në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkëmbim përvoje të stafit akademik; - Pjesëmarrje në kërkime dhe projekte të përbashkëta; - Organizim të konferencave apo simpoziumeve shkencore të Përbashkëta.
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Në vijim të vizitës në terren vihet re se programi i studimit mundëson, dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Organizim të seminareve të përbashkëta me pjesëmarrjen e studentëve, ekzistenca e revistës shkencore me punime të ndryshme si dhe pasurim të bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Mbështetur në Planin Strategjik të Zhvillimit të Kolegjit, evidentohet se, politika kërkimore-shkencore në Kolegjin Universitar “REALD” synon të fokusohet më tepër në drejtimet e mëposhtme:</p> <p>a) Të pajisë studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale në fushën e shkencave ekonomike duke kontribuar në zhvillimin kombëtar dhe rajonal të fushës;</p> <p>b) Të kryejë veprimtari studimore dhe kërkimore jo vetëm në kërkimin shkencor bazë, por edhe në zhvillimin e kërkimit shkencor të aplikuar dhe të risive teknologjike dhe organizative;</p> <p>c) Të realizojë pubikime dhe konferenca shkencore ndërkombëtare me pjesëmarrjen e lektorëve të huaj të shquar, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave për zhvillimin e vazhdueshëm të stafit akademik dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e</p>	<p>Bazuar në planin financiar për menaxhimin me efektivitet të institucionit si dhe pasqyrave financiare të kolegjit, vihet re se, për realizimin e</p>

shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administrohet nga ardhurat nga aktivitete të ndryshme	aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore Departamenti nuk vepron i veçuar financiarisht nga veprimtaria e Kolegjit dhe të gjitha aktivitetet e ndryshme të zhvilluara mbështeten financiarisht nga institucioni si dhe të ardhurat administrohen nga Zyra e Financës. Për kërkimin shkencor KUR ka një fond prej 3000 eurosh, ndërkohë që botimi në buletin është pa pagesë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Referuar planit strategjik të zhvillimit të KUR si dhe listës së bashkëpunimit ndërinstytucional të tij, u konstatua se institucioni ka krijuar lidhje me universitete të tjera kërkimore shkencore, si Universiteti “Luarasi”, Universiteti Mesines dhe Salerno, Itali si dhe Kolegji “Pjetër Budi”, Kosovë.			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Bazuar në rregulloren e KUR, Strategjinë e Zhvillimit si dhe planit vjetor për kërkim shkencor, theksojmë se njësia përgjegjëse, synon të angazhojë stafin akademik dhe studentët në projekte dhe kërkime shkencore, por ky angazhim është në nivele të ulëta dhe ka nevojë të rritet më shumë në aktivitete ta karakterit shkencor.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Bazuar në dokumentin “Plan Pune i kerkimit shkencor 2019-2020” rezulton se njësia përgjegjëse, ka organizuar aktivitete të tilla si, leksione të hapura, konsultime apo mbledhje me stafin por nuk vihet re ndonje aktivitet i mirëfillte shkencor. Njësia bazë duhet të organizojë më shpesh konferenca shkencore për fushën e programit të studimit të cilat do të ndihmojnë arritjen e objektivave nga personeli dhe studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1				
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Institucioni ka hartuar një plan masash në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Mund të përmendet udhëzuesi për hartimin e punimit të diplomës (<i>Evidenca 46</i>). Për mësimin online përdoret platforma google classroom, jepen video ilustruese të përdorimit të saj etj. (<i>Evidencat 61, 62 dhe 63</i>).			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	KUR ka ngritur dhe bërë funksionale NJSBC-në e cila merret me monitorimin dhe vlerësimin e mësimdhënies, mekanizmi kryesor i përdorur nga institucioni për vlerësimin e mësimdhënies është pyetësi i studentëve (<i>Evidenca 47</i>). Nga takimi me studentët në IAL, u konfirmua ky fakt. GVJ rekomandon që institucioni të përdore edhe mekanizma të tjerë alternative për vlerësimin e aftësive inovative të stafit akademik, duke përfshirë dhe analiza nga ekspertë jashtë institucionit.			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Referuar <i>evidencave 32.1 dhe 32.2</i> , institucioni me anë të pyetësorëve ben pjesë të vlerësimit të cilësisë edhe studentët. Këta të fundit u shprehën të kënaqur në lidhje me marrjen e opinionëve të tyre në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në drejtime të ndryshme, gjatë takimit të zhvilluar në institucion.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	NJSBC harton raportin vjetor mbi rezultatet e vlerësimit por ky raport nuk shihet i publikuar në faqen zyrtare të institucionit. (<i>Evidenca 30</i>)			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Qendra Kërkimore dhe Departamenti promovojnë praktikat më të mira të kërkimit shkencor duke evidentuar dhe promovuar stafin që ka qenë më tepër i angazhuar në këtë drejtim (<i>Evidenca 55</i>). Gjithashtu gjatë takimit në IAL stafi akademik i departamentit u shpreh se ka marrë edhe mbështetje financiare shtesë, për kërkimin shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

 26 

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Referuar planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve rezulton se format e mësimdhënies janë vetëm dy, leksione dhe seminare, mungojnë orët praktike lëndore, detyrat e kursit apo projektet. GVJ rekomandon që në planin mësimor të jenë të përfshira dhe format e sipërpërmendura të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Referuar Rregullores së Etikës, stafi akademik duhet të ndjekë parime si integriteti, objektiviteti, përgjegjshmëria etj. Gjithashtu mund të pohohet se nga takimi me studentët në IAL vihet re se personeli akademik i përgjigjet dhe i respekton diversitetin e nevojave të studentëve për fushën e studimit të bankës dhe tregjeve financiare ashtu edhe metodat e mësimdhënies e komunikimin pedagog-student.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik të programit të studimit por bazuar edhe në DVV, dokumenti “<i>Plani Vjetor - Kerkimi Shkencor - 2019 - 2020 (1)</i>”, rezulton se KUR bën përpjekje në nxitjen e stafin akademik për të marrë pjesë në trajnime, kualifikime e leksione të hapura. Megjithatë këto përpjekje duhet të jenë më të mëdha duke marrë parasysh se programi i studimit në fjalë është një program Master i Shkencave, ku në thelb të tij ka përgatitjen e studenteve të aftë për të punuar në projekte apo kërkim shkencor. Nuk vihet re ndonjë pjesëmarrje e stafit akademik të programit në konferenca ndërkombëtare me fokusin e programit të studimit në fjalë.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Referuar CV-ve të stafit akademik të programit të studimit, rezulton se stafi akademik është me eksperiencë në fushën e lëndëve të cilat ata mbulojnë. I gjithë stafi i angazhuar në këtë program studimi ka tituj dhe grada. Nisur dhe nga komentet e marra gjatë takimeve në IAL me studentët, mund të thuhet se stafi është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve në këtë fushë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Referuar dokumentit “<i>Formular NJSBC - Vleresim i studentit per pedagogun</i>” vihet re se institucioni vlerëson format e mësimdhënies në mënyrë periodike përmes pyetësorëve anonimë që iu mundësohen studentëve për ti plotësuar, GVJ është e mendimit se institucioni duhet gjithashtu të përdorë edhe mekanizma të tjerë vlerësues. NJSBC më pas analizon rezultatet e këtyre pyetësorëve dhe harton një raport me gjetjet e tyre. Megjithatë nuk rezulton që institucioni të këtë hartuar një plan masash për adresimin e sugjerimeve, ankesave apo mendimeve të</p>

	studentëve. Nga takimet në institucion rezultojnë se rezultatet e pyetësorëve iu vihen në dispozicion studentëve dhe pedagogëve por ato nuk janë të bëra publike në faqen eeb të institucionit.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Nga vizita në institucion, studentët u shprehën të kënaqur edhe në këtë drejtim. Në syllabuset e lëndëve jepen mënyrat e vlerësimit të studentëve ku përfshihet edhe aktivizimi gjatë orës së mësimit, diskutime etj. Në tërësi mund të thuhet që i lihet hapsira e mjaftueshme studentit për të debatuar, aktivizuar, shprehur mendime dhe marrë vlerësime për këto.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Studentët mund të shprehin lirshëm mendimet e tyre, vlerësimet dhe kritikën për aspekte të ndryshme të mësimit. Këtu vlen për tu përmendur edhe fakti që Bordi i Administrimit ka një fond të veçantë në mbështetje të aktiviteteve studentore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesisë dhe aftësinë profesionale, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentin “ <i>Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i> ”, rezultojnë se institucioni ka hapësirat janë të mjaftueshme për realizimin e këtij programi studimi. Ambjentet cilësore dhe auditorët të ndara në godinë me 3 kate. Gjithashtu disa auditorë janë në formë laborator, të pajisur me kompjuter dhe internet.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Ambjentet janë funksionale dhe me logjistikën e nevojshme. Funksionale për sa i përket hapsirës dhe përmasave e me logjistikën e nevojshme duke qenë se shumica janë të pajisur me video projektorë, kompjutera etj, apo edhe mundësi interneti për studentët.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Edhe personeli akademik edhe studentët mund të shfrytëzojnë laboratorët me kompjutera të pajisur me internet. Në këtë format ishin duke u shtuar edhe salla të reja mësimi, siç u konstatua gjatë vizitës. Gjithashtu për komunikim midis studentëve dhe pedagogëve përdoren emailët zyrtarë të IAL në formatin @unireal.edu.al dhe platforma Google Classroom për mësuesin online. (Evidencat 37 dhe 38)
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale),	Literatura bazë dhe ndihmëse vendoset në dispozicion për studentët në bibliotekën e IAL por edhe në rrugë elektronike. Nga vizita në institucion mund të thuhet se biblioteka ishte e pasur me tituj në gjuhën shqipe dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	atë të huaj, por GVJ sugjeron që të shohen titujt që i parkasin më konkretisht fushës së financës dhe të tregjeve financiare në veçanti, siç është përmëndur dhe mësipër në këtë raport, literature e përdorur në syllabuset e lëndëve nuk është ajo e pesë viteve të fundit. GVJ rekomandon që institucioni të shtojë fondin e bibliotekës me tituj të botimeve të viteve të fundit.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka ka hapsira të mjaftueshme për tu përdorur njëkohësisht gjatë ditës nga studentët dhe pedagogët. Në bibliotekë nuk ka shumë tituj që nuk lidhen drejtpërdrejt me programin e studimit por iu nevojiten studentëve për detyra kursi në disa lëndë.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Nga shqyrtimi dosjes së vetëvlerësimit por dhe nga vizita në institucion, rezulton se institucioni nuk ka abonime aktive në librari online. GVJ-së i është vënë në dispozicion një listë me tituj librash të cilat institucioni i ka shkarkuar nga librari të ndryshme online, por kjo nuk vërteton faktin që institucioni ka abonime aktive me këto library në funksion të studentëve të këtij programi studimi.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Refearuar dokumentit “ <i>Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i> ”, vihet re se në funksion të këtij programi studimi, institucioni ka në dispozicion vetëm një laborator, atë të informatikës i cili është i pajisur me 30 kompjutera. Duke marrë parasysh që laboratori i informatikës ka një funksion të përgjithshëm në institucion, duke u përdorur dhe nga programe të tjera që IAL ofron, GVJ rekomandon që institucioni të rrisë kapacitetet e tij laboratorike, për të bërë të mundur ushtrimin e orëve praktike që përmban plani mësimor i këtij programi studimi.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Platforma Online që përdoret është Google Classroom. Përdorimi i platformave online në fakt tashmë është një detyrim i kohës për shkak të situatës së pandemisë dhe nuk mund të konsiderohet risi si në të kaluarën por gjithësesi mund të thuhet se ky kriter përmbushet nga IAL në përgjithësi dhe për programin e studimit.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion të GVJ nga IAL, rezulton se institucioni nuk disponon një system të brendshëm të komunikimit apo menaxhimit të informacionit. Komunikimi i brendshëm realizohet kryesisht nëpërmjet faqes zyrtare ëëë.unireald.edu.al dhe emailt zyrtare emër.mbiemër@unireald.edu.al.
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Referuar dokumentit “ <i>Udhëzuesi për punimin e temes së diplomës</i> ”, rezulton se ka një procedurë të qartë ku studentëve iu njoftohen temat në dispozicion sipas fushës së programit të studimit që ata ndjekin dhe mund të bëjnë në këtë mënyrë zgjedhjen e lirë. Por gjithashtu ka një udhëzues të qartë që përcakton të gjithë elementët e diplomës që nga kopertina, formati i përmbajtjes, literatura, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Referuar rregullores së NJSBC dhe Planit të punës të NJSBC, rezulton se njësia përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional është NJSBC. Kjo njësi harton plan pune që miratohet nga Rektori i KUR dhe e ndjek atë në vitin pasardhës.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Departamenti i Financës është njësia përgjegjëse për realizimin e procesit mësimor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së tyre dhe përmirësimin e programeve mësimore. Pavarësisht përjekjeve që kanë bërë drejtuesit e institucionit, fakultetit dhe departamentit, bazuar në vizitën e realizuar në institucion dhe dokumentacionin mbështetës të RVB-së, rezulton se ka ende punë për të rritur vetë ndërgjegjësimin te personeli akademik në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Institucioni ka siguruar infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor dhe praktikave laboratorike, por referuar dokumentit “Plan Pune i kerkimit shkencor 2019-2020”, rezulton se impakti i aktivitetit kërkimor që ka realizuar personeli akademik, për studime të avancuara, kërkime shkencore, etj., po ashtu dhe angazhimi i personelit nuk është në nivelin e duhur. Megjithatë vlen të theksohet se personeli akademik i anagzhuar në mësimdhënie në këtë program studimi zotëron së paku gradën gradën “Doktor”.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Bazuar në vizitën në IAL rezulton se institucioni i ka siguruar infrastrukturën fizike të nevojshme departamentit për trajnim të stafit akademik për zbatimin e metodave inovative në mësimdhënie në bashkëpunim me strukturat drejtuese dhe departamentet e tjera te IAL. Por mos angazhimi i tyre, nuk ka çuar në efekte të dukshme në rritjen e përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies. Si rrjedhojë, GVJ rekomandon që institucioni të sigurojë dhe promovojë përdorimin e

	teknologjisë dhe metodave inovative të mësimdhënies duke motivuar personelin akademik dhe studentët.			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik ka përgjegjësi për zbatimin e programit të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit. Për këtë mund të thuhet se në rregullore dhe syllabuse janë të qarta, mënyra e vlerësimit etj. Gjithashtu personeli akademik informohet mbi rezultatet e pyetësorëve anonimë që plotësohen nga studentët, në lidhje me kërkesat për përmirësimin e mësimdhënies.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Referuar dosjes së vetëvlerësimit dhe vizitës në institucion, nuk rezultojnë asnjë dokument analizues apo raportues i personelit akademik në lidhje me metodat e reja të mësimdhënies të testuara. I vetmi instrument vlerësimi apo testimi për mbetet pyetësori që realizon NJSBC me studentët. GVJ rekomandon që institucioni të hartojë raportë periodike mbi rezultatet e testimit të metodave të reja që personeli akademik implementon.			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Bazuar në dokumentin “ <i>Plan Pune i kerkimit shkencor 2019-2020</i> ”, rezultojnë se institucioni realizon takime apo konferenca të veçanta që shërbejnë për shkëmbim eksperience dhe shpërndarje të informacionit duke ftuar profesorë të huaj kryesisht nga Italia për tema të caktuara, seminare, konferenca, etj. Këto aktivitete i shërbejnë përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive përcaktohen qartë në rregulloret e Departamentit dhe të Fakultetit. Gjithashtu ka një rregullore të veçantë për zhvillimin e provimeve. (Evidencat 21, 44 dhe 58). Në fillim të vitit studentëve iu prezantohet syllabusi i lëndës, mënyra e vlerësimit etj. Vlerësimi total kryhet i ndarë në dy pjesë, 30 pikë gjatë vitit dhe 70 pikë provimi përfundimtar. (Evidenca 19).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Provimet hartohen me pyetje me shtjellim, teste me alternativa dhe ushtrime si dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse. Nga takimet me studentët nuk kishte ndonjë pakënaqësi apo vërejtje në përgjithëse mbi mënyrën e hartimit të tezave të provimeve. (Evidenca 44).
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

 31 

profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi bëhet deri diku i shpërndarë gjatë vitit dhe kjo është e pasqyruar në syllabuse dhe rregullore (Evidencat 18 dhe 44). Përgjithësisht nga 5% janë frekuentimi, detyra e kursit dhe aktivizimi në seminare, 15% provimi i pjesshëm dhe 70% ai përfundimtar. Por GVJ mendon se duke qenë një program Master i Shkencave, duhet të zgjerohet më shumë vlerësimi gjatë vitit duke shtuar pjesën kërkimore.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore u konstatua se nuk përdoren sisteme elektronike të testimit në këtë program studimi. Provimi zhvillohet nga dy pedagogë, njëri prej të cilëve është pedagogu i lëndës. Rezultatet e provimit dalin që pas 3 ditësh dhe kjo realizohet lehtësisht për shkak të numrit jo të lartë të studentëve.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimi i dijeve kryhet me shkrim dhe në mënyrë anonime me sekretim. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë dhe komisionit të provimit. Në pjesën e pasme të fletës së provimit janë të shënuara kriteret e vlerësimit. Referuar dokumentit “Rregullore për Zhvillimin e Provimeve – 2018” Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Komisioni i vlerësimit mbledh kërkesat e studentëve dhe pas rishikimit të fletës së provimit cakton një datë për të biseduar me studentët. Pedagogu pasi ka korigjuar provimet, shkodimi bëhet në prani të sekretares.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Referuar dokumentit takimit që GVJ realizoi me studentët e këtij programi studimit, rezulton se pedagogu i lëndës konsultohet me studentët pas korigjimit të provimeve duke bërë në këtë mënyrë dhe një ballafaqim me ta, për të arsyetuar vlerësimin e dhënë, gjithashtu studenti ka të drejtë të kërkojë rishikimin e provimit nëqoftëse nuk është i bindur me vlerësimin dhe shpjegimin e marrë. Rishikimi mund të kryhet në prezencë të pedagogut të lëndës nëqoftëse studenti kërkon të marrë sqarime.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk	Bazuar në rregulloren e provimeve, parashikohen masat që merren në këtë drejtim. Studenti penalizohet nëqoftëse kopjon në provime dhe gjithashtu

tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	paralajmërohet ose merren masa nëqoftëse ka plagjiaturë gjatë përgatitjes së temës së diplomës. Por insitucioni nuk disponon një sistem/program anti plagjiaturë.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Referuar rregullores së programit të studimit, sistemi i notave është nga 1 deri në 10. Nota ngelëse është 4, kaluese është 5. Provimet vlerësohen me pikë që konvertohen në nota sipas shkallëzimit përkatës.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët njihen në kohë me vlerësimin dhe nqs kanë paqartësi apo ankesa mund të kërkojnë rishikimin e provimit sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Provimeve. Nga takimet e zhvilluara, studentët u shprehën të kënaqur në këtë drejtim.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Referuar rregullores së programit të studimit dhe takimit me përgjegjësen e departamentit, nëqoftëse studenti kryen ankimim, përgjegjësi i departamentit i drejtohet dekanit dhe më pas ngrihet komision i posaçëm për rishikimin e provimit brenda 24 orësh, vihet në dijeni student për ngritjen e komisionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Duke parë shpërndarjen e lëndëve në planin mësimor, mund të thuhet që janë të dy kategoritë të përfaqësuara edhe lëndët teorike e që garantojnë thellimin e njohurive por edhe lëndët që kanë karakter më tepër profesional. GVJ është e mendimit se quke qënë një program Master i Shkencave, mund të vendoset pak më tepër theksi tek formimi teorik.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Bazuar në planin mësimor, nuk ka ndonjë lëndë që zhvillohet në gjuhë të huaj por gjuha e huaj është detyrim për tu pranuar në programin e studimit, ashtu si për çdo program Master i Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Në lidhje me këtë kriter mund të përmendet lënda “Sistemet e Menaxhimit të Informacionit dhe Metodologjia e Kërkimit Shkencor”.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Referuar takimit me studentët dhe stafin akademik rezultoi se pedagogu i lëndës në fund të semestrit /vitit realizoi një seancë ku behet përmbledhja e lëndës, ecuria, arritja e objektivave fillestare të lëndës. Pedagogu organizon një përmbledhje të temave dhe çështjeve të diskutuara dhe orienton

<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>studentët për provimin përfundimtar, mënyrën e organizimit të tij dhe vlerësimit të dijeve.</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore (Evidenca 53), institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e financës dhe tregjeve financiare, apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre.</p> <p>Në këto aktivitete ftohen dhe lektorë të huaj të cilët zhvillojnë leksione të hapura në gjuhë të huaj, që asistohen me përkthyes. Por institucioni nuk disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve.</p>			
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “<i>Marreveshjet e bashkëpunimit për zhvillimin e praktikës mesimore</i>”, GVJ konstaton se institucioni ka lidhur marrëveshje për realizimin e praktikave profesionale që zhvillohen në institucione publike dhe private si dhe në planin mësimor ka lëndë që zhvillohen në laboratorin e informatikës, siç është lënda “Sistemet e Menaxhimit të Informacionit dhe Metodologjia e Kërkimit Shkencor”.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Bazuar në takimin me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet studentët në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon KUR, temave të kursit, projekte kërkimi, kryerjen e diplomës si dhe gjatë kryerjes së praktikës profesionale në institucione publike apo private.</p>			
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>				
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, takimeve të realizuara me stafin akademik, dekanin dhe përgjegjësen e departamentit, GVJ-së ju e bë e ditur se institucioni ve në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve për kërkimin shkencor një fond prej 300 eurosh si dhe u mundëson atyre publikime/botime në buletin shkencor të institucioni, pa pagesë. Megjithatë GVJ në dosjen e vetëvlerësimit nuk konstatoi asnjë dokument për të faktuar këtë gjë. GVJ rekomandon që institucioni të këtë të dokumentuar dhe transparent mënyrën dhe procesin e përfitimit t nga fondi prej 300 eurosh, të studentëve dhe stafit akademik.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe takimeve në institucion, GVJ nuk identifikoi metoda alternative të mësimdhënies ku personeli akademik në bashkëpunim me institucionet bashkëpunuese të ketë mundësuar apo rritur mobilitetin e studentëve. Mobilitete jashtë vendit apo studentë të huaj nuk ka.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi III.8**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, më konkretisht Evidencave 5, 7 dhe 46, rezulton se, institucioni ka udhëzues për hartimin e temës së diplomës dhe procedura të qarta për mbrojtjen e saj. Disa prej këtryre udhëzuesve janë gjithashtu publike në faqen zyrtare të IAL.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Bazuar në Evidencat 5 dhe 46, studentit i caktohet udhëheqës teme me gradë shkencore. Ai harton së bashku me udhëheqësin planin e punës, mbikëqyret në çdo etapë të realizimit të tij e deri në mbrojtjen e temës përpara komisionit të caktuar.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas Evidencës 5, Komisioni i mbrojtjes së diplomës miratohet nga dekani pas propozimit të përgjegjësit të departamentit. Mbrojtja zhvillohet me pyetje përgjigje që testojnë njohuritë e studentit mbi temën dhe profilin ku ai po diplomohet.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Udhëheqësi i temës së diplomës e orienton studentin që nga momenti i përzgjedhjes së temës e cila duhet të jetë brenda profilit e më pas në të gjitha etapat e hartimit e deri në fazën përfundimtare të mbrojtjes para komisionit.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Kjo realizohet përmes pedagogut udhëheqës. Ai është personi që asiston në emër të stafit akademik. Nuk ka palë të tjera të përfshira në këtë proces përveç atyre të përmendura në kriteret e mësipërm.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Referuar Evidencave 5 dhe 46, si dhe takimit me studentët, udhëheqësi e ndjek studentin në të gjitha etapat dhe garanton cilësinë e punimit të diplomës duke e firmosur atë. Duke e ndjekur hap pas hapi dhe analizuar rezultatet merr përgjegjësinë në fund të procesit dhe garanton me emrin e tij se punimi është i vlefshëm për tu prezantuar për mbrojtje para komisionit.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas vlerësimit të udhëheqësit dhe vlerësimit të secilit anëtar komisioni pasi studenti prezanton punimin e tij me mbrojtje të hapur, kryhet vlerësimi me notë i studentit (Evidenca 5).
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me	




diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në dokumentin “ <i>Suplementi Msc - Financë dhe Tregje Financiare</i> ”, GVJ konstaton se studenti në përfundim të studimeve në këtë program studimi, pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës të miratuara nga MASR.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar takimit që GVJ pati me studentët e këtij programi studimi dhe Evidencave 14, 15 dhe 16, rezulton se në përfundim të studimeve studentit i vendosen në dispozicion këto materiale në formatet zyrtare të miratura të tyre.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Bazuar në rregulloren e Sekretarisë Mësimore, rezulton se IAL ruan për një periudhë kohe të pacaktuar dokumentacioni e studentit, të cilat edhe arkivohen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se KUR disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi, koordinatorin. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik. Dosja përmban materiale ku mund të përmenden CV e zgjeruar, të dhëna personale, fotokopje të artikujve të botuar në revista shkencore apo punimeve të prezantuara në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare etj, të cilat më pas përditësohen herë pas here.
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e	Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, GVJ, u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi dosjet e personelit akademik, kontratat e punës

brendshme rregullatore të institucionit.	të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga KUR (Evidenca 11).			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	GVJ rekomandon që në aktet rregullatore të përfshihen dhe saktësohen më tepër kriteret specifike të rekrutimit.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Referuar rregullores së Burimeve Njerëzore, rekrutimi i stafit akademik bazohet në aktet ligjore në fuqi. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik; procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Referuar dokumentit “ <i>Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i> ”, GVJ konstaton se KUR ka siguruar kushtet, hapësirat dhe infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin e programit të studimit me qëllim kryerjen në mënyrë profesionale të detyrave të tyre.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga takimi me personelin akademik, personeli shprehet se institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre por ndërkohë nuk u evidentuan raste konkrete të zhvillimit profesional dhe akademik të personelit të institucionit veçanërisht për stafin e programit të studimit Masteri Shkencave në “Financë dhe Tregje Financiare”
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni deklaron se ka kryer aktivitete shkencore dhe leksione të hapura, me pjesëmarrje të stafit akademik dhe studentëve në aktivitetet shkencore kombëtare apo vizita shkëmbim eksperience me institucione analoge në Itali në funksion të kualifikimit profesional të personelit akademik. Por institucioni nuk disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve. Aktivitetet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional, për njohjen e stafit me teknologjitë e reja dhe zbatimin e tyre

	në procesin mësimor deklarohet se zhvillohen, por GVJ nuk evidentoi zbatime të këtyre metodologjive në procesin mësimor.			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit dhe listës së personelit akademik për këtë program studimi, GVJ konstaton se institucioni ka anagzhuar burimet e nevojshme njerëzore për realizimin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët, janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi normal mësimor. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimorë, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking. Institucioni disponon sistem ngrohje-ftohje qendrore, sistem sigurimi pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyje hidrosanitare, sistem të mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion (Evidenca 34).
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ vizitoi auditorët mësimorë të cilat ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. Institucioni ka zgjeruar kapacitetin pritës me ambiente të reja (kati -1) në të njëjtën godinë.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Bazuar në vizitën në insitucion GVJ konstaton se, pajisjet e mjedisëve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me video projektor dhe me pajisjet e tjera të nevojshme. Laboratori i vetëm në fukSION të këtij programi studimi përmban aparaturat dhe mjetet e tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit. Institucioni ka të instaluar një laborator informatike të pajisur

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit. Megjithatë GVJ është e mendimit së institucioni duhet të rrisë kapacitetin e tij sa i përket laboratorëve duke diversifikuar në këtë mënyrë mundësitë e studentëve për zhvillimin e praktikës lëndore.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	KUR ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private kryesisht për zhvillimin e praktikave profesionale që parashikohen në planin mësimor të programit të studimit (Evidenca 27). Gjatë takimit me studentët ata u shprehën të kënaqur nga praktika profesionale dhe një pjesë e tyre më pas janë punësuar në institucionin ku kryen praktikën profesionale të mundësuar nga KUR.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë javës 08:00-16:00 dhe të Shtunën. Gjithashtu duke patur parasysh hapësirën dhe numrin e studentëve, garantohej plotësisht shfrytëzimi i Bibliotekës nga studentët e këtij programi studimi.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është e pasur me literaturë fizike dhe të ndarë sipas programeve të studimit që të jetë më e thjeshtë për studentët dhe stafin akademik. Në lidhje me programin e studimit, ka tituj për natyrën e programit të studimit dhe që mund të përdoren nga studentët për detyra kursi dhe projekte të ndryshme kërkimore. Megjithatë siç është përmendur dhe me lart në këtë raport, në sullabuset e lëndëve të këtij programi studimi vihet re një literature e vjetër dhe jo e 5 viteve të fundit. GVJ rekomandon që institucioni të pasurojë Bibliotekën me tekste për në funksion të këtij programi studimi të paktën të 5 viteve të fundit.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Referuar dosjes së vetëvlerësimit por edhe vizitës në institucion GVJ nuk konstatoi abonimin e institucionit në librari onlinë të cilat kanë lidhje me fushën e programit të studimit. GVJ është e mendimit se KUR duhet të krijojë kushte për akses të në bibliotekat on-line të fushës së mjekësisë të cilës i përket dhe programi i studimit.

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është e pajisur me 20 kompjutera dhe pajisje teknike që mundësojnë shfrytëzimin nga ana e të gjithë studentëve dhe kjo edhe sepse siç thuhet më lart nuk kemi të bëjmë me numër shumë të lartë studentësh.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni synon zgjerimin e vazhdueshëm të numrit të titujve të Bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues. Kjo gjë parashikohet edhe në planin e kërkimit shkencor për vitin 2019-2020 (Evidenca 37).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Siç përmendet edhe më lart, biblioteka është në dispozicion të studentëve gjatë javës 08:00-16:00 dhe në fundjavë ditëve të Shtuna. Pra edhe gjatë orareve të mësimin të studentëve edhe përtej tyre. Kjo është e mjaftueshme për numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar dosjes së vetëvlerësimit dhe rregullorës së Sekretarisë Mësimore, të dhënat e studentëve që nga aplikimi e regjistrimi i tyre, provimet, e deri në diplomimin e tyre, ruhen dhe administrohen nga Sekretaria Mësimore përmes procedurave të qarta. Por nuk konstatohet se institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili të funksionojë në bazë të rregullores të sipërcituar.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni nuk ka një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit . Është Zyra e Burimeve Njerëzore ajo që administron të gjitha të dhënat në lidhje me stafin akademik dhe stafin ndihmësakademik të KUR. Në këtë zyrë ndodhen dosjet e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Dosjet përmbajnë CV të zgjeruar, të dhëna personale, fotokopje të artikujve shkencorë e punimeve të tjera etj (Evidenca 36).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Siç përmendet dhe mësipër në këtë standard KUR nuk disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit, si rrjedhojë GVJ e ka të pamundur të analizojë përmbushjen e këtyre kriterëve.

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.				
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.				
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Institucioni disponon faqen e tij të internetit eëë.unireald.edu.al e cila përmban informacione të vlefshme për informimin e publikut. Faqja e internetit ofrohet vetëm në gjuhën shqipe. Megjithatë nga vizita në institucion u konstatua se po punohet për ofrimin e faqes së internetit edhe në gjuhën angleze dhe italiane. Informacionet në lidhje me programet e studimit, përmbajtjen, strukturën/organigramën duhet të publikohen dhe përditësohen në kohë reale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Zyra e Financës harton raportin vjetor financiar të IAL (Evidencat 41, 68 dhe 69). Bordi i Administrimit parashikon fonde për mbështetjen financiare të aktiviteteve studentore apo kërkimin shkencor të stafit akademik. Megjithatë institucioni nuk harton raport financiar për kostot e këtij programi studimi. GVJ rekomandon hartimin e një raport financiar në bazë programi studimi dhe jo vetëm të IAL-së.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat	Në raportin financiar të paraqitur (Evidenca 41), mungon një pasqyrë të hollësishme financiare e të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare në kuadër të këtij programi studimi. GVJ nuk identifikoi analiza mbi të cilat të jenë hartuar politika apo ndërhyrjet e posaçme në buxhet për diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij për vitet në vijim.

on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.									
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Bazuar në dokumentacioni e dosjes së vetëvlerësimit të këtij program studimit konstatohet se nuk ka dokumentacion në lidhje me auditimin për vitin 2019. Por dhe ai i vitit 2018 (Evidenca 41), është më shumë një bilanc sesa një auditim I mirrëfilltë. Institucioni duhet të kryejë audite financiare të përvitshme edhe në zbatim të kuadrit rregullator financiar në Republikën e Shqipërisë.								
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Programi i studimit Msc në “Financë dhe Tregje Financiare”, nuk ka plotësuar akoma një cikël të plotë duke qënë se është një program i ri studimi.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	KUR është një institucion jo publik i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentet shoqëruese deklarohet se burime të financimit janë tarifat e studentëve (regjistrimit dhe shkollimit) dhe pjesa tjetër e buxhetit financohet nga kompania mëmë. Përdorimi i fondeve ka shkuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, investimit në laboratorë dhe auditorë, shtimit të titujve në bibliotekë, proceseve të informatizimit, punësimit të stafit akademik Institucioni garanton kapacitete financiare për të siguruar qëndrueshmërinë e tij gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe gjenerimin e të ardhurave në vazhdimësi. (Evidenca 41).								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1				
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Procedurat që nga pranimet e studentëve pra që në hyrje e deri në humbjen e statusit të studentit, përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, të miratuar me vendim të Senatit Akademik. GVJ referuar kësaj rregulloreje evidenton se në të nuk ka të përcaktuara kritere specifike apo të përgjithshme për pranimet në këtë program studimit, por i vetmi kusht që studentët duhet të plotësojnë për tu regjistruar në këtë program studimi është disponimi i një diplome Bachelor.			
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion, takimi me studentët, GVJ konstaton se institucioni zhvillon procedura transparente duke siguruar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët. Referuar rregullores së programit të studimit, përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i caktuar nga dekanati mbështetur në dokumentacionin e paraqitur, notës mesatare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe Vendimeve të Senatit Akademik. Në takimin me përfaqësues të fakultetit dhe departamentit u deklarua që aplikohen kritere përzgjedhëse për regjistrimin në programin Master i Shkencave, por GVJ nuk identifikoi raste të aplikimit të këtyre kritereve.			
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.				
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Referuar faqes së internetit të institucionit, informacioni i publikuar në faqen e internetit lidhur me programet, regjistrimet etj, është i mjaftueshëm dhe orientues. Po ashtu, shumica e rregulloreve janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit . Informacioni për regjistrimet jepet edhe nëpërmjet broshurave të përgatitura për maturantët, javët e informimit etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e pranimit. Ato janë publike dhe të aksesueshme nga të gjithë. Studentët për të kaluar nga viti i parë në vitin e dytë, duhet të kenë grumbulluar të paktën 30 kredite (Evidenca 5).			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloren e përgjithshme, nenet 54, 55 dhe 56 tregohen modalitetet e transferimit në programet e tjera të KUR, njohja e studimeve etj. Për procedurat e transferimeve, me vendim të rektoratit ngrihet komisioni përkatës në nivel Kolegji. Përbërja e komisionit ndryshohet me vendim të rektorit. Në çdo departament, me urdhër të dekanit, ngrihen komisionet e ekuivalentimit dhe vlerësimit të cilat miratohen prej tij. Të gjitha llojet e transferimeve bëhen mbi bazën e kërkesës së studentit duke plotësuar një formular tip. Ky formular publikohet në faqen zyrtare të Kolegjit së bashku me informacionin e nevojshëm. Kërkesa për transferime pranohen dhe administrohen në Sekretarinë mësimore gjatë gjithë viti akademik, deri në 10 shtator të çdo viti, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga aktet e tjera nënligjor			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Vlerësimi i studentëve është paraqitur në rregulloren e përgjithshme, rregulloren e programit dhe syllabuset e lëndëve ose moduleve. Të gjithë këta elementë përfshihen në syllabusin e lëndës si mënyra e vlerësimit që zakonisht është 30 pikë gjatë vitit dhe 70 pikë provimi përfundimtar. 30 pikët e vitit zakonisht ndahen në 15 pikë një provim i pjesshëm, 5 pikë frekuentimi, 5 pikë aktivizimi në seminare dhe 5 pikë detyra e kursit. Duke qenë një program Master i Shkencave, GVJ është e mendimit se duhet të shtohet pesha e detyrës së kursit. Gjithashtu GVJ ka identifikuar mospërputhje në metodologjinë e vlerësimit midis rregulloreve dhe syllabuseve përsa i përket % që zë vlerësimi gjatë vitit akademik dhe vlerësimi përfundimtar ose provimi.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga takimi që GVJ realizoi me studentët rezultoi se ata janë të informuar për kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës. Ky informacion ndodhet në Udhëzuesin e hartuar nga IAL për punimin e diplomës i cili i vendoset në dispozicion në mënyrë shumë të thjeshtë studentëve.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Në takimet me drejtuesit, u theksua se KUR informon vazhdimisht studentët e rinj në lidhje me institucionin, personelin dhe infrastrukturën që ai disponon. KUR publikon broshura informimi dhe informacione të vlefshme në faqen e internetit. Organizohen fushata promovionale, shpërndahen postera dhe reklama në media në lidhje me programin e studimit, përpara fillimit të vitit akademik (Evidenca 39 dhe 40).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Referuar dosjes së programit të studimit dhe takimit me studentët, GVJ konstaton se studentët informohen nga personeli akademik, sekretaria mësimore për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Gjithashtu ata gjejnë informacion të nevojshëm në planin mësimor i cili përmban informacion mbi kohëzgjatjen e studimeve dhe ngarkesën në orë dhe kredite.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	KUR vë në dispozicion të studentëve informacione dhe dokumente për zhvillimin e lëndëve/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Syllabuset tregojnë shkurtimisht detyrimet e studentit në lidhje me lëndën/modulin. Ky informacion i vendoset studentëve në dispozicion në fillim të vitit akademik.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në rregulloren e zyrës së këshillimit të karrierës, institucioni deklaron se procesi i zhvillimit dhe këshillimit të karrierës është i lidhur ngushtësisht me formimin akademik të studentëve, të ardhmen e të cilëve institucioni e sheh të lidhur me mundësinë e punësimeve në institucionet jashtë dhe brenda vendit, falë bashkëpunimit të ngushtë institucioni publike dhe private, por njëkohësisht studentëve ju krijohet mundësia që nëpërmjet iniciativave publike e private, konferencave, leksioneve të hapura, serive të diskutimeve dhe debateve periodike, jo vetëm të përgatiten profesionalisht, por të kenë qasjen korrekte ndaj botës akademike, duke formuar një profil akademik individual, i cili do t'ju vlejë në karrierën e nesërme, por edhe në studimet e mëtejshme.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Rerferuar takimit me studentët, ata deklarojnë se kanë informacionin dhe mbështetjen e duhur nga ana e institucionit, rezulton se ata janë të kënaqur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Këto informacione studentëve ju behen të ditura që në javën e parë të fillimit të vitit akademik.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni është i arritshëm nga studentët në distancë nëpërmjet faqes zyrtare të internetit eëë.unireald.edu.al. GVJ nuk konstaoi nje sistem të mirëfilltë të brëndshëm të menaxhimit.

Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrosh informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Këta elementë administrohen nga Sekretaria Mësimore. GVJ nuk konstatoi një sistem të mirëfilltë të brendshëm të menaxhimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administrosh, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Sekretaria mësimore mbledh dhe mban të dhëna në formë elektronike (Excel) për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program për vitin 2018-2019 ka qenë 19 dhe vitin 2020-2021, 9 studentë. Ky program akoma nuk ka nxjerë brezin e parë të të diplomuarve, duke qenë një program i ri.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Këto të dhëna ruhen dhe administrohen nga Sekretaria Mësimore e KUR. Nisur nga numri i ulët i studentëve, aktualisht kjo mënyrë e mbajtjes së të dhënave është efiçente por në të ardhmen institucioni duhet të krijojë infrastrukturë IT për administrimin dhe menaxhimin e të dhënave të studentëve në sekretarinë mësimore. Në rastet e largimeve para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve, studentët tërheqin dokumentacionin e nevojshëm.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Referuar vizitës në institucion, takimit në sekretarinë mësimore dhe takimit me studentët, të dhënat statistikore të studentëve administrohen nga Sekretaria Mësimore por jo në forme të automatizuara. Siç është përmendur dhe mësipër në këtë raport, institucioni nuk disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e	Institucioni përfshin në raportin vjetor të institucionit të dhëna mbi studentët në hyrje dhe në dalje (Evidenca 17). Sa i përket punësimit ky program është një program i ri dhe akoma nuk ka nxjerë brezin e parë të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	të diplomuarve, si rrjedhojë institucioni nuk mund të ketë akoma raporte analitike për këtë çështje.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në dokumentet kryesore të institucionit (statuti, rregullorja e përgjithshme etj), studentët janë të përfshirë në strukturat vendimmarrëse të KUR. Studentët janë të organizuar në strukturat studentore në nivel fakulteti dhe në nivel kolegji. Edhe në takimin me studentët ata deklarojnë se janë të përfshirë dhe pyeten nga drejtuesit e institucionit. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik është e mundur bazuar në aktet rregullatore. Megjithatë GVJ nuk konstatoi ndonjë dokument që verteton rezultatet e përfshirjes së studentëve në organet vendimmarrëse apo këshilluese.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Referuar planit mësimor të programit të studimit dhe takimit me studentët GVJ konstaton se ngarkesa akademike e studentëve mbahet parasysh gjatë hartimit të programit të studimit pasi nga shpërndarja e lëndëve në planin mësimor duket normale. Gjithashtu nuk mund të thuhet se ka procedura burokratike për njohjen e studimeve të plota ose të pjesshme të mëparshme, ndonëse ka rregullime të përcaktuara në aktet e IAL (Evidenca 5).
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Nga takimet e zhvilluara në IAL por edhe nga sa pohohet në dokumentacion, mendimi i studentëve merret në këtë drejtim por ende nuk ka patur sugjerime të studentëve mbi rishikimin apo përmirësimin e programit të studimit edhe për faktin se ky program është një program i ri studimi.
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e	Studentëve iu jepet mundësia e shprehjes në këtë drejtim. Madje pas provimit ata mund të paraqiten për të marrë sqarimet përkatëse nga pedagogu nqs kanë paqartësi. Gjithashtu nëqoftëse nuk binden ata më pas mund të ankimojnë rezultatin duke u ngritur komision i ri vlerësimi me

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	propozim të përgjegjësit të departamentit dhe miratim të dekanit etj. (Evidenca 5)			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Referuar dokumentin “Plani Vjetor - Kerkimi Shkencor 2019 – 2020”, GVJ konstaton se stafi akademik i këtij programi studimi nuk ka marrë pjesë në ndonjë konferencë ndërkombetare. GVJ rekomandon që institucioni dhe vetë stafi akademik, të bëjnë më shumë përkjekje për pjesëmarrjen në konferenca ndërkombetare me fokus kërkimin shkencor. Kjo do të lunate një rol të rëndësishëm edhe në ndërkombëtarizimin e programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	KUR ka marrëveshje me institucione të huaja kryesisht në realizimin e mësimdhënies me pedagogë të huaj kryesisht italianë. Por GVJ, referuar dosjes së vetëvlerësimit nuk konstaton që institucioni të këtë realizuar ndonjë projekt apo kërkim të përbashkët me këto institucione.
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Gjatë takimit që GVJ pati me studentët e këtij programi studimi, ata u shprehën se personeli akademik i motivon studentët për të publikuar punimet e tyre shkencore sidomos në Buletinin Shkencor të KUR dhe faqen e internetit. Por GVJ nuk konstatoi ndonje publikim të punëve shkencore të studentëve.
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Referuar takimeve në institucion më dekanin dhe përgjegjësen e departamentit, rezulton se KUR ve në dispozicion të personelit akademik për kërkim shkencor një fond prej 3000 eurosh. Por referuar dosjes së vetëvlerësimit dhe CV-ve të stafit akademik, GVJ nuk evidentoi ndonjë punim shkencor të 2 viteve të fundit të publikuar nga stafi akademik i këtij programi studimi.
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Nga takimi që GVJ realizoi me studentët e këtij programi, ata u shprehën se mbështeten në realizimin e detyrave të kursit, praktikave profesionale, hartimi i temës së diplomës etj dhe studime kërkimore në fushën e programit të studimit. Për inovacion dhe patenta është ende herët të flitet për këtë program studimi.




Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Referuar takimit me studentët dhe stafin akademik rezulton se udhëheqësi i temës së diplomës asiston studentin në kryerjen e analizave, matjeve, studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi V.7				
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Referuar dosjes së vetëvlerësimit (Evidenca 26 dhe 27), KUR bashkëpunon me IAL publike si Universiteti Ismail Qemali Vlorë etj. me qëllim mobilitetin e stafit dhe studentëve të programit të studimit. Por për këtë program studimi nuk ka patur rastë të mobilitetit të studentëve.			
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Referuar syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi rezulton se, metodat e kërkimit të përfshira në syllabusin e disa lëndëve janë të mjaftueshme për të nisur studime në ciklin e tretë, si psh. lënda që zhvillohet në laboratorin e informatikës.			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit GVJ nuk konstaton të dokumentuar ndonjë politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendas apo të huaj në projekte kërkimore, kjo edhe për faktin se siç e kemi përmendur dhe më sipër në këtë raport, ky është një program i ri studimi.			
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.				
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Referuar takimit me dekanin, përgjegjësen e departamentit dhe stafin e programit të studimit, rezulton se institucioni është i orientuar drejt këtij synimi, por nuk ka ende rezultate në këtë drejtim. GVJ rekomandon që ky të jetë një objektiv për të ardhmen.			
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Referuar planit mësimor, syllabuseve dhe listës së personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, rezulton se ka staf 1 akademik të huaj të përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Standardi V.8				
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni nuk ka hartuar procedura specifike në shërbim të studentëve. Bazuar në deklaratimet e studentëve, ata e marrin informacionin e nevojshëm nga Sekretaria Mësimore.			
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ nga dokumentacioni i dosjes së vetëvlerësimit dhe nga vizita në institucion, konstatoi se institucioni nuk ka një strukturë të posaçme për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Këtë rol e kryen sekretaria mësimore e cila ndjek ecurinë e studentëve gjatë vitit akademik. Studentët marrin në këtë strukturë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe dokumente që iu nevojiten.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në rregulloren e përgjithshme, si strukturë ekziston zyra për këshillimin e karrierës. Sikundër u theksua më lart, si nga studentët edhe nga dokumentacionin në dispozicion, rezulton se është sekretaria mësimore struktura që mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike. Informacioni i dhënë është kryesisht për orientimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor, orientimin për praktikën profesionale etj. Studentët orientohen saktë në lidhje me to dhe gjatë takimeve të kryera nga vizitat në KUR ata u shprehën mjaft të kënaqur. Madje një pjesë e tyre ishin punësuar më pas në institucionin privat si psh bankë, ku kishin kryer praktikën profesionale të parashikuar në programin e studimit.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Referaur këtij programi studimi mund të analizohet puna e zyrës së karrierës në këtë drejtim pasi, dukë qënë një program i ri, akoma nuk ka nxjerrë brezin e parë të studentëve të diplomuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në aktet e brendshme rregullatore si: nenin 27 dhe 28 të Statutit të KUR, nenit 13 dhe 83 të Rregullores së Brendshme të KUR, Rregullores së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, RVB si dhe nga takimi i GVJ me drejtuesit të NJBSC të KUR, kjo njësi ndjek realizimin e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. Gjithashtu, kjo njësi ka si qëllim të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik, të hartojë standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të Kolegjit në përputhje me standardet si dhe të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji. Zbatimi i rregullores për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë ndiqet kryesisht nga strukturat e sistemit të brendshëm të cilësisë dhe nga Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë. Përmes zbatimit të pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura në të cilat marrin pjesë edhe studentët, ata nëpërmjet opinionëve të tyre i jepnin rëndësi sigurimit të cilësisë në KUR si dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të saj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sipas Statutit të KUR, Rregullores së KUR si dhe Rregullores së NJSBC, RVB, dhe siç konstatuan edhe ekspertët në vizitë, Sigurimin e Jashtëm i Cilësisë e realizon nëpërmjet proceseve për vlerësimin e jashtëm të akreditimit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi si dhe duke i'u bërë i njohur për publikun. Megjithatë GVJ është e mendimit se institucioni duhet të realizojë edhe procese të tjera në funksion të vlerësimit të jashtëm. Gjithashtu GVJ sugjeron që institucioni duhet të aktivizojë ekspertë të jashtëm në NJSBC.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sipas nenit 5 dhe 6 të Rregullores së NJSBC-së, dhe nga vizita e GVJ, KUR analizon kryesisht mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to vetëm mendimin e studentëve nëpërmjet pyetësorit të studentëve. GVJ rekomandon që</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë</p>	<p>Sipas nenit 5 dhe 6 të Rregullores së NJSBC-së, dhe nga vizita e GVJ, KUR analizon kryesisht mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to vetëm mendimin e studentëve nëpërmjet pyetësorit të studentëve. GVJ rekomandon që</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	<p>institucioni krijon mekanizma për të marrë në konsideratë edhe mendimin e aktorve të tjerë, siç mund të jenë përfaqësesit e tregut të punës, opinionin e pedagogëve etj. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm duhet të realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të ASCAL. Konkluzionet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetsorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin joakademik dhe studentët.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Nga vizita në institucion dhe RVB, u vu re se KUR ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit në FE. Ky proces u realizuar gjatë hartimit të programit dhe duke qenë se programi është i ri, aktualisht nuk ka pasur nevojë për rishikim programi Nga vizita në KUR bazuar edhe në dokumentacion, këto dy vitet e fundit nuk ka patur ndryshime në këtë program.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Referuar rregullores së Sigurimit të Brendshëm së Cilësisë, RVB si dhe nga takimit të GVJ me drejtuesit të NJBSC, kjo njësi ndjek realizimin e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. Gjithashtu, kjo njësi ka si qëllim të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik, të hartojë standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të Kolegjit në përputhje me standardet si dhe të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji. Instrumenti kryesor që NJSBC përdor për mbikëqyrjen e cilësisë së programit të studimit është pyetësori i studentëve i cili realizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri. Institucioni ka hartuar një raport në lidhje me rezultatet e vlerësimit të dala nga këto pyetësore por nuk ka hartuar një plan masash për përmirësimin e gjetjeve apo konstatimeve të dala nga ky raport. (Evidenca 30).

Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Sipas RVB, nenit 6 të Rregullores së NJSBC; Statutit dhe Rregullores së KUR si dhe vizitës së GVJ në institucion, u vu re se KUR përdor disa metoda për matjen dhe vlerësimin e programit Msc “Financë dhe Tregje Financiare”, çdo vit, qoftë nëpërmjet njësisë bazë ose nëpërmjet NJSBC.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Bazuar rregulloren e NJBSC, NJSBC përmes zbatimit të pyetësorëve përpiqet të kuptojë nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Konkluzionet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave të pyetësorëve, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin joakademik dhe studentët. Megjithatë GVJ është e mendimit se, raporti duhet të përcaktojë ndryshimet që duhet të bëhen në programin e studimit dhe rregulloren e tij mësimore, në procesin e implementimit, në bazën materiale e didaktike, në stafin akademik, në procedurat e kontrollit të dijeve e vlerësimit të studentëve, në procesin e marrjes së “feedback”-ut nga studentët.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Bazuar në aktet e brendshme rregullatore si: nenin 27 dhe 28 të Statutit të KUR, nenit 13 dhe 83 të Rregullores së Brendshme të KUR, Rregullores së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, RVB si dhe nga takimi i ekspertëve me drejtuesit të NJBSC të KUR, kjo njësi ndjek realizimin e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. Gjithashtu, kjo njësi ka si qëllim të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik, të hartojë standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të Kolegjit në përputhje me standardet si dhe të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji. Zbatimi i rregullores për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë ndiqet kryesisht nga strukturat e sistemit të brendshëm të cilësisë dhe nga Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Përmes zbatimit të pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura në të cilat marrin pjesë edhe studentët, ata nëpërmjet opinionëve të tyre i jepnin

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

 53 

	rëndësi sigurimit të cilësisë në KUR si dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të saj.			
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Sipas akteve rregullatore të brendshme si Rregullore e NJSBC, Pyetësorët për studentët, KUR përdor metoda vlerësimi si intervista dhe pyetësorë për studentet aktualë. Nga konstatimi i ekspertëve në institucion, anketimi i studentëve nëpërmjet pyetësorëve është një instrument i rëndësishëm që përdoret për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, rezultatet e të cilit bëhen të njohura dhe shërbejnë si një bazë orientuese për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Përmes zbatimit të pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura në të cilat marrin pjesë edhe studentët, ata nëpërmjet opinioneve të tyre i jepnin rëndësi sigurimit të cilësisë në KUR si dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të saj. KUR bazohet kryesisht në pyetësorin e studentëve për vlerësimin, si dhe në takimet e zhvilluara me stafin dhe studentët. Është e rëndësishme që KUR ti kushtojë më shumë rëndësi vlerësimeve paralele të detyrave apo vëzhgimeve në auditor.			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program	Gjithashtu GVJ përveç pyetësorëve të studentëve nuk konstaton metoda apo instrumeta të tërthortë siç mund të jenë pyetësorët me stafin akademik apo administrative etj. Siç është përmendur më lart, institucioni duhet të verë në zbatim mekanizma gjithëpërfshirës dhe ti përdorë informacionet e mbledhura jo vetëm për vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit por edhe për vetëvlerësime periodike të performancës dhe ecurisë aftatgjatë të institucionit gjë që nuk është realizuar			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen

Sipas Statutit të KUR, Rregullosës së NJSBC, planin e punës së NJSBC si dhe RVB dhe sic ekspertët konstatuan, ishte se KUR ka parashikuar

<p>e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>politika që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurave për sigurimin e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Gjithashtu sipas strukturës organizative dhe hirarkisë të KUR përgjegjësitë për cilësinë janë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet, reaktorat) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit në KUR, është konceptuar si përgjegjësi e menaxhimit, ku është parashikuar angazhimi i gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë; sigurimi i burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë si dhe hartimi i programeve cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë; përcaktimi i parimeve, standarteve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë. GVJ evidenton se përfshirja e studentëve në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit nuk rezulton në nivelin e duhur pasi që kontributi i tyre është mjaft i ulët në lidhje me informacionin që ata japin, propozimet që bëjnë dhe përgjegjësitë që marrin në lidhje me këtë proces.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e NJSBC, Rregulloren e KUR, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë si dhe RVB, për realizimin e planit mësimor për çdo program studimi, FE koordinon veprimtarinë mësimore-shkencore në të dy departamentet. Kjo mundëson mirëorganizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Përcaktimi i ngarkesës mësimore në KUR bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Gjithashtu, rregullorja e KUR, Rregullorja e FE, Rregullorja e NJSBC, garantojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazitë kundrejt personelit dhe studentëve. NJSBC është strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në KUR, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë si dhe standardet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapsirën Evropiane të Arsimit të Lartë. NJSBC duhet të planifikojë organizimin e vlerësimin të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit dhe të vlerësimin të brendshëm institucional. Për të realizuar këtë ngrihet grupi i vlerësimin të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizimet studentore.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimin duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në rast nevojë, ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm me përvje të gjere akademike. Grupi i vlerësimin të brendshëm ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, 1 (një) përfaqësues I Këshillit Studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm. Anëtarët zgjidhen në mënyrë të posaçme nga Senati Akademik për një periudhë 4 vjeçare me mundësi rizgjedhjeje.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimin dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Në rast nevojë, ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm me përvje të gjere akademike. Grupi i vlerësimin të brendshëm ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, 1 (një) përfaqësues I Këshillit Studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm. Anëtarët zgjidhen në mënyrë të posaçme nga Senati Akademik për një periudhë 4 vjeçare me mundësi rizgjedhjeje.</p>

	Pavarësisht përcaktimeve të plota në kuadrin rregullator, në zbatimin e tij duhet ti kushtohet rëndësi më e madhe aktivizimit të ekspertëve të jashtëm, personelit ndihmës apo edhe atij administrativ në proceset e vlerësimit. Angazhimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj është i mangët dhe për këtë arsye kërkohet angazhim më i madh nga ana e institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Sipas akteve rregullative si, Rregullores së NJSBC, RVB, Pyetësorët e studentëve si dhe nga vizita e ekspertëve në institucion, u vu re se, mbledhja e informacionit për sistemin e sigurisë janë pyetësorët e realizuar studentëve. Anketat e pyetësorëve përpunohen dhe i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit. NJSBC aktivitetin e saj e zhvillon sipas një plani pune të përvitshëm, në të cilin programohen kontrollat në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit/vlerësimit, duke parashikuar rezultatet e pritshme e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sipas RVB, apo Rregullores së NJSBC dhe takimit të GVJ në institucion, raportet e NJSBC analizohen nga Senati Akademik, i cili duhet t'a miratojë atë. Rektorati duhet të marrë masat për zbatimin e planit të veprimeve sipas afateve të përcaktuara. NJSBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të Kolegjit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm vjetore. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e KUR, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Nga takimi i ekspertëve me drejtues të institucionit, NJSBC, dekanin dhe dhe përgjegjësën e departamentit të financës, u kontstatua se organizohen takime me stafin dhe studentët në sigurimin e cilësisë së programit. Megjithatë, në kuadër të përmirësimit afatmesëm dhe afatgjatë të cilësisë së programit të Msc në "Financë dhe Tregje Financiare", GVJ nuk evidentoi
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	takime të formalizuara me stafin e brendshëm, të jashtëm dhe studentët si dhe aktivitete trajnuese për aktet rregullatore të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Financë dhe Tregje Financiare” të institucionit të arsimit të lartë Kolegji Universitar
“REALD”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Ky program do të shërbejë në përgatitjen e specialistëve të financës dhe tregjeve financiare, me qëllim kryesor punësimin si punonjës të: institucioneve financiare (publike e private), të departamenteve financiare e ekonomike të Bashkive, drejtues korporatash apo menaxher kryesor.
2. Një pjesë e personelit akademik zotëron tituj akademikë dhe eksperiencë të gjatë në tregun e punës.
3. KUR ka bashkëpunime ndërinstitucionale me institucione publike e private, me një sërë institucioneve shtetërore dhe IAL brenda e jashtë vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës në përgjithësi.
4. Institucioni ka hartuar një plan masash në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.
5. Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është e pajisur me 20 kompjutera dhe pajisje teknike që mundësojnë shfrytëzimin nga ana e të gjithë studentëve dhe kjo edhe sepse siç thuhet më lart nuk kemi të bëjmë me numër shumë të lartë studentësh.
6. Infrastruktura e institucionit kryesisht garanton zhvillimin e programit në standartet e kërkuara.
7. Ngarkesa e ulët e numrit të studentëve për një pedagog dhe raportet e mira midis pedagogëve dhe studentëve.

Pika të dobta

1. Sa i përket raportit teori-praktikë, në planin mësimor nuk vihen re orë praktike, përveç praktikës profesionale, duke bërë që programi i studimit të ketë ngarkesë të theksuar teorike.
2. Dokumentacioni i paraqitur në kuadrin e akreditimit të këtij programi në disa raste ka mangësi, ku u evidentua se kishte disa pasaktësi midis tabelave të mbledhura me të dhënat e pedagogëve dhe emrave të paraqitur në syllabuset dhe dosjen e programit të studimit.
3. Kërkimi shkencor si dhe mbështetja financiare e drejtpërdrejtë e personelit akademik për kërkimin shkencor lënë për të dëshiruar.
4. Struktura/Zyra të ndryshme të institucionit si Zyra e Këshillimit të Karrierës; Zyra e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë, apo edhe zyra të tjera, të cilat duhet të jenë në funksion të programit, janë formale.
5. Një prej objektivave të studimeve në Fakultetin e Ekonomisë të KUR lidhet me zhvillimin e programeve të reja të studimit në përshtatje me nevojat e shoqërisë, kushtet ekzistuese dhe perspektivat e zhvillimit të vendit tonë. Megjithatë këto objektiva nuk janë reflektuar me tej në hartimin e një studimi tregu.
6. Në raportin financiar të paraqitur, mungon një pasqyrë e hollësishme financiare e të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare në kuadër të këtij programi studimi.



7. Mungojnë mekanizmat e tjerë alternative për vlerësimin e aftësive innovative të stafit akademik, duke përfshirë dhe analiza nga ekspertë jashtë institucionit.

Rekomandime

1. GVJ është e mendimit se në planin mësimor duhet të përfshihen dhe praktikat lëndore reflektuar kjo në kreditet përkatëse.
2. Strukturat mbështetëse të vihen në funksion të këtij programi, të formalizohen dhe të funksionojnë sipas standarteve të kërkuara. Gjithashtu, duhet siguruar që të dhënat e personelit të jenë të përditësuara dhe të mbajtura me rregull të plotë.
3. Në planin financiar të institucionit të parashikohet një shumë mbështetëse për aktivitetet e kërkimit shkencor të personelit akademik të programit.
4. GVJ është e mendimit se institucioni duhet të hartojë një studim tregu për të patur një pasqyrë më të qartë të kërkesës së tregut sidomos në rajonin ku bën pjesë IAL. Studimi i tregut i cili gjendet në dosjen e vetëvlerësimit që IAL ka dorëzuar është një studim i përgjithshëm dhe me fokus në turizëm, rrjedhimisht nuk jep një pasqyrë të qartë të situatës për këtë program studimi.
5. GVJ rekomandon që institucioni të hartojë një raport financiar ku të përfshijë një pasqyrë e hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare në kuadër të këtij programi studimi.
6. GVJ rekomandon që institucioni të përdore edhe mekanizma të tjerë alternative për vlerësimin e aftësive innovative të stafit akademik, duke përfshirë dhe analiza nga ekspertë jashtë institucionit.
7. Kreditet për çdo lëndë mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore dhe punën individuale që duhet kryer nga student, GVJ rekomandon që kreditet për çdo lëndë të jenë të ndara sipas rëndësisë specifike të lëndëve, ndërkohë që në planin mësimor aktual çdo lëndë, pavarësisht katërkohë, ka 6 kredite.
8. Në gjykimin e GVJ lëndët karakterizuese të programit duhen të kenë një peshë me të madhe në program dhe rrjedhimisht kjo reflektuar dhe në orë apo kredite.
9. Njësia bazë duhet të organizojë më shpesh konferenca shkencore për fushën e programit të studimit të cilat do të ndihmojnë arritjen e objektivave nga personeli dhe studentët.
10. GVJ rekomandon që institucioni të sigurojë dhe promovojë përdorimin e teknologjisë dhe metodave inovative të mësimdhënies duke motivuar personelin akademik dhe studentët.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science in Finance and Financial Markets, offered by the “REALD” University College

Strengths and affirmations

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



1. This program will serve in the preparation of specialists of finance and financial markets', with the main purpose of employment as employees of: financial institutions (public and private), financial and economic departments of municipalities, corporate leaders or chief manager.
2. A part of the academic staff has academic titles and long experience in the labor market.
3. KUQ has inter-institutional cooperation with public and private institutions, with a number of state institutions and IAI inside and outside the country, as well as with companies and offices, part of the business community or labor market in general.
4. The institution has drafted a plan of measures at the institutional level for the development and use of various and innovative teaching methods.
5. From the visit to the institution it results that the Library is equipped with 20 computers and technical equipment that enable the use by all students and this is because as stated above we are not dealing with a very high number of students.
6. The infrastructure of the institution mainly guarantees the development of the program to the required standards.
7. The low student load per lecturer and the good relationship between lecturers and students.

Weaknesses

1. Regarding the theory-practice ratio, in the curriculum there are no practical hours, except for professional practice, causing the study program to have a significant theoretical load.
2. The documentation presented in the context of the accreditation of this program in some cases has shortcomings, where it was noted that there were some inaccuracies between the tables collected with the data of professors and names presented in the syllabus and the file of the study program.
3. Scientific research and direct financial support of academic staff for the scientific research have yet a lot to improve.
4. Different institution structures/offices such as Career Counseling Office; The Quality Assurance Office, or even other offices, which should be in function of the program, are only formal.
5. One of the objectives of studies at the Faculty of Economics of KUQ is related to the development of new study programs in accordance with the needs of society, existing conditions and development prospects of our country. However these objectives are not further reflected in the design of a market study.
6. In the submitted financial report, there is a lack of a detailed financial statement of income from tuition fees and other financial contributions for students or the allocation of financial resources within this study program.
7. Lack of the alternative mechanisms for assessing the innovative skills of academic staff, including analysis by experts outside the institution.

Recommendations

1. EET is of the opinion that in the curriculum should be included the subject practices reflected in the respective credits.
2. The support structures should help the functioning of this program, should be formalized and should function in compliance with the required standards. Also, the personnel records should be kept up to date and kept in full order.
3. In the financial plan of the institution should be foreseen a budget for the research activities of the academic staff of the program.
4. EET is of the opinion that the institution should compile a market study to have a clearer picture of market demand, especially in the region where IALs are part of.
5. GVJ recommends that the institution should prepare a financial report which includes a detailed financial statement of income from tuition fees and other financial contributions for students or the allocation of financial resources under this study program.
6. EET recommends that the institution use other alternative mechanisms for assessing the innovative skills of academic staff, including analysis by experts outside the institution.
7. Credits for each subject take into account the workload in the lesson and the individual work to be performed by the student, so EET recommends that the credits for each subject be divided according to the specific importance of the subjects, while in the current curriculum each subject, regardless of category, has 6 credits.
8. In the judgment of the EET, the characteristic subjects of the program should have a greater weight in the program and consequently this is reflected in the hours or credits.
9. The basic unit should organize more often scientific conferences in the field of the study program which will help the achievement of the objectives by the staff and the students.
10. EET recommends that the institution ensure and promote the use of innovative technology and teaching methods by motivating academic staff and students.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	